



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 559 Akti

Nr. 634 Vendimi
Tiranë, më 10.3.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bektashi Kryesuese
Pamela Qirko Relatore
Roland Ilia Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në datën 23.2.2023, ora 10:00 dhe në datën 8.3.2023, ora 12:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Naim Tota**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancat dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES/SEANCAT DËGJIMORE

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit Naim Tota, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është subjekt që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.6.2020, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit Naim Tota do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 2, i përbërë nga komisionerët Brunilda Bekteshi, Pamela Qirko dhe Roland Ilia. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Pamela Qirko.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 19.6.2020, u caktua me mirëkuptim kryesuese znj. Brunilda Bekteshi, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Naim Tota.

5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit Naim Tota nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ).

10. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Naim

¹ Akti përfundimit të kontrollit me nr. *** prot., datë 29.10.2018.

Tota. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

11. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin² e mbajtur për subjektin e rivlerësimit Naim Tota, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

12. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve gjyqësore, duke dërguar një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit Naim Tota.

13. Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe me provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në datën 24.1.2023 vendosi⁴: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për këto tri kriteret për subjektin e rivlerësimit Naim Tota; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit⁵ për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

15. Subjekti i rivlerësimit, në datën 26.1.2023, u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 1.2.2023, si dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën 20.2.2023 (nëpërmjet postës elektronike dhe depozitimit në protokollin e Komisionit).

16. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht me *email*, në datën 20.2.2023.

17. Në datën 23.2.2023 u zhvillua seanca e parë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit 84/2016, gjatë së cilës u relatuan rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe subjekti paraqiti sërish argumentet dhe shpjegimet e tij lidhur me to. Subjekti i rivlerësimit Naim Tota mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje

² Raporti mbi kontrollin e figurës me nr. *** prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 17.6.2022, të KDZH-së.

³ Raporti për analizimin e aftësive profesionale me nr. *** prot., datë 30.11.2022.

⁴ Vendimi i ndërmjetëm nr. ***.

⁵ Një nga anëtarët e trupit gjykues (relatorja e çështjes) ishte kundër kalimit të barrës së provës sa i përket situatës së dyshuar për fshehje pasurie, pasqyruar kjo rrethanë në vendimin e ndërmjetëm nr. ***, datë 24.1.2023 dhe procesverbalin përkatës të mbledhjes së trupit gjykues, të po kësaj date.

me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit Naim Tota kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

18. Trupi gjykues, i mbledhur në dhomë këshillimi po në datën 23.2.2023, në shqyrtim të prapësimeve të paraqitura dhe provave mbështetëse mbi rezultatet e hetimit, si dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti gjatë seancës dëgjimore, në prezencë edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, vendosi riçeljen e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit Naim Tota. Vendimi për riçeljen e hetimit u mor për kryerjen e një analize me qëllim evidentimin e mundësisë financiare të shtetasit T.H për likuidimin deri në fund të vitit 2003, të çmimit të blerjes së apartamentit të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, pasuri e cila në vijim është përfituar prej subjektit me kontratën e cedimit të vitit 2016.

19. Në datën 27.2.2023, Komisioni i bëri të ditura rezultatet shtesë të hetimit administrativ dhe, pasi subjekti u njoh me to, ka dërguar prapësimet e tij duke depozituar edhe prova të reja shtesë mbi të ardhurat e shtetasit T. H. dhe familjarëve të tij, por edhe për rrethana që lidhen me rezultatet e hetimit kryesisht të dërguara më parë nga Komisioni, të cilat do të vlerësohen me objektivitet gjatë vendimmarrjes.

20. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet shtesë të hetimit, në datën 6.3.2023, vendosi të ftojë z. Naim Tota në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim që të paraqesë komentet dhe deklaratat e tij në lidhje me: (a) vlerësimin e provave; (b) rezultatet shtesë të hetimit; dhe (c) rezultatin e mundshëm të procedurës së rivlerësimit.

21. Në datën 8.3.2023 u zhvillua seanca e dytë dëgjimore me subjektin e rivlerësimit Naim Tota, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, gjatë së cilës u relatuan rezultatet shtesë të hetimit, si dhe subjekti paraqiti sërish argumentet dhe shpjegimet e tij përfundimtare lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të kryer nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit Naim Tota mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit Naim Tota kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

II. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

22. Z. Naim Tota ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

22.1 Subjekti i rivlerësimit, z. Naim Tota ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

III. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

23. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

23.1 Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

23.2 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

23.3 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

23.4 Ndërsa, në kreun VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

23.5 Por, referuar vendimit nr. 2/2017⁶ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

24. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) “Deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*” të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja; (ë) denoncimet e publikut; dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato dhëna gjatë seancave dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

25. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklaratimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit, si dhe në verifikimin e ligjshmërisë së burimeve të krijimit të këtyre pasurive.

25.1 Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të paraqitur më parë në këtë institucion, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Naim Tota.

25.2 Në deklaratën *Vetting* (shtojca ***), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 30.1.2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se zotëron këto pasuri:

26. Apartament banimi 2+1, i ndodhur në rrugën “*”, Tiranë, përfituar me kontratën e cedimit të datës 16.3.2016, me vlerë 50,000 USD.**

⁶“41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5 të nenit 179/b të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

26.1 Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar: (i) të ardhurat në shumën 5,000,000 lekë, të përfituara nga shitja e apartamentit në Kukës; dhe (ii) të ardhurat dhe kursimet ndër vite.

Deklarimi i kësaj pasurie ndër vite

26.2 Në deklaratën e interesave privatë periodikë/vjetorë (në vijim DIPP) të vitit 2016 (dorëzuar në ILDKPKI më 30.3.2017), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë e llojit “apartament banimi 2+1”, të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, përfituar me kontratën e cedimit të datës 16.3.2016, me burim krijimi: (i) të ardhurat nga shitja e apartamentit në Kukës; dhe (ii) të ardhurat e kursimet ndër vite.

26.3 Komisioni konstaton se në deklaratat e interesave privatë/periodikë vjetorë për vitet 2004 – 2015, subjekti ka deklaruar si adresë ku është regjistruar në gjendjen civile dhe adresë banimi rrugën “****”, Tiranë (pallati ***), e cila duket se lidhet me adresën e pasurisë objekt vlerësimi, por pa përcaktuar marrëdhënien ligjore me të. Rezulton se vetëm në DIPP-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar se banon me qira në adresën: Njësia nr. ***, rruga “****”, Tiranë.

26.4 Gjithashtu, rezulton se në DIPP-në e vitit 2017, në seksionin “ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, subjekti ka deklaruar: “*Hipotekuar me certifikatën për vërtetim pronësie nr. ***, apartamenti 2+1 (sipërfaqe totale 96.21 m²), në datën 22.8.2017, në rrugën ‘****’, Tiranë, blerë me kontratën e cedimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.3.2016, deklaruar më parë*”.

26.5 Konkluzion i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri

- *Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjet e ardhura nga institucionet përkatëse.*
- *Subjekti ka deklaruar prej vitit 2005, në rubrikën “Adresa e plotë ku jeni regjistruar në gjendjen civile”, adresën e apartamentit në rrugën “****”, pallati “****”, Tiranë.*
- *Është e paqartë se subjekti ka përfituar apartamentin me sip. 102.51 m² në Tiranë, me kontratën e cedimit datë 16.3.2016, në vlerën 50.000 USD, nga shtetasi T. H (bashkëshorti i motrës së subjektit), ndërkohë që ky shtetas i detyrohet atij për shumën 40,000 euro prej vitit 2008. Gjithashtu, i paqartë është edhe fakti i vlerës së njëjtë prej 50,000 USD nga viti 2003, kur ceduesi e ka përfituar apartamentin, deri në vitin 2016, kur subjekti është përfitues i tij.*

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

26.6 Referuar informacionit dhe dokumentacionit të dërguar nga ASHK Drejtoria Vendore Tirana Jug⁷, konfirmohet se në emër të subjektit të rivlerësimit figuron e regjistruar pasuria me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e llojit “apartament”, me sip. 86.21 m² dhe me sipërfaqe të përbashkët 10.58 m², ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, identifikuar si pasuria objekt vlerësimi.

26.7 Komisioni verifikoi dhe analizoi në mënyrë të detajuar informacionin/dokumentacionin e administruar në dosjen e hetimit administrativ⁸ për mënyrën e krijimit dhe fitimit të pasurisë objekt vlerësimi, nga ku rezultoi se:

i. Në datën 3.4.2003 shtetasi T.H (identifikuar si bashkëshorti i motrës së subjektit të rivlerësimit) ka porositur⁹ nga shoqëria “****” sh.p.k., pasurinë e llojit “apartament banimi 2+1”, me sip. 102.51 m², ndodhur në katin e tretë të objektit (pallatit) që do ndërtohej/po

⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 9.11.2020, e ASHK Drejtoria Vendore Tirana Jug, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.11.2020.

⁸ (i) Dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting* (ndodhur aneksin nr. ***, aneksin nr. *** dhe aneksin nr. ***, në dosjen e ILDKPKI-së); (ii) shkresa nr. *** prot., datë 9.11.2020, e ASHK Drejtoria Vendore Tirana Jug, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.11.2020; (iii) dokumentacioni i përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 27.7.2022, të ILDKPKI-së, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 28.7.2022.

⁹ Kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., datë 3.4.2003, konfirmuar me dokumentin noterial “vërtetim nënshkrimi”, redaktuar nga noteri publik, znj. V. S.

ndërtohej nga kjo shoqëri në rrugën “***”, Tiranë, sipas vendimit nr. ***, datë 26.5.2001, të KRRT-së.

Në kontratën e sipërmarrjes të nënshkruar mes palëve është përcaktuar se, vlera totale e apartamentit do të jetë 50,000 USD dhe se do të likuidohet me këste, përkatësisht: (a) kësti i parë në vlerën 25,000 USD në datën e nënshkrimit të kontratës (datë 3.4.2003); (b) kësti i dytë në vlerën 10,000 USD, brenda datës 30.6.2003; dhe (c) kësti i tretë në vlerën 15,000 USD, brenda datës 30.10.2003. Gjithashtu, në këtë kontratë është specifikuar se apartamenti objekt transaksioni do t’i dorëzohet porositësit brenda majit të vitit 2004.

Bashkëlidhur me kontratën e sipërmarrjes datë 3.4.2003, evidentohen tri mandatpagesa¹⁰ pjesërisht të lexueshme, nga ku duket se shtetasi T.H ka likuiduar plotësisht gjatë vitit 2003 shumën 50,000 USD në favor të shoqërisë “***” sh.p.k., përkatësisht: (a) në datën 3.4.2003 shumën 25,000 USD; (b) në datën 26.6.2003 shumën 10,000 USD; dhe (c) në datën 29.12.2003 shumën 15,000 USD.

ii. Në datën 16.3.2016, nënshkruhet kontrata e cedimit të të drejtave¹¹ të kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., datë 3.4.2003, në referim të së cilës shtetasi T.H paraqitet në cilësinë e “ceduesit” të të drejtave dhe subjekti i rivlerësimit në cilësinë e “përfituesit” të të drejtave, në lidhje me pasurinë objekt vlerësimi. Referuar deklarimeve paraprahe të bëra nga palët në këtë kontratë, ndër të tjera, është përcaktuar se:

- *Ceduesi ka nënshkruar kontratën e sipërmarrjes nr. *** rep. në datën 3.4.2003, me shoqërinë sipërmarrëse “***”, e cila ka për objekt blerjen e një apartamenti 2 dhoma e 1 kuzhinë, kati i 3-të, me orientim nga lindja dhe me sipërfaqe 102.51 m², të ndodhur në rrugën “***”, Tiranë. Çmimi për këtë apartament është përcaktuar në vlerën 50,000 USD.*
- *Për sa është parashikuar në këtë kontratë, pagesa e vlerës së apartamentit do të bëhej me këste: kësti i parë në vlerën 25,000 USD; kësti i dytë në vlerën 10,000 USD; kësti i tretë në vlerën 15,000 USD.*
- *Ceduesi deklaroi se pagesat e këtyre tri kësteve në vlerë totale 50,000 USD, që i ka likuiduar shoqërisë sipërmarrëse, i janë dhënë nga përfituesi.*
- *Përfituesi ka paguar për blerjen e të drejtave të apartamentit sipas parashikimeve të përcaktuara në kontratën e sipërmarrjes.*

Ndërsa, në nenin 2 të kësaj kontrate, me titull “Çmimi i kontratës dhe mënyra e pagesës”, është përcaktuar se vlera totale e kontratës është 50,000 USD, e cila është likuiduar e gjitha nga “përfituesi” të “ceduesit” jashtë zyrës noteriale.

iii. Në datën 7.6.2016, mes palës ceduese dhe përfituese të të drejtave është nënshkruar dokumenti “Saktësim kontrate”¹², në referim të të cilit kanë deklaruar se në një prej paragrafëve të deklarimeve paraprahe të kontratës së cedimit gabimisht kanë shënuar që shumën 50,000 USD, që i është likuiduar shoqërisë sipërmarrëse, i është dhënë nga përfituesi. Në vijim, parashtrojnë se ky paragraf është i shkuar gabim nga ana tyre, pasi shuma 50,000 USD është dhënë nga ceduesi tek sipërmarrësi dhe jo nga ana e përfituesit, prandaj në këtë paragraf shprehja “i është dhënë nga përfituesi” duhet hequr dhe është e gabuar.

iv. Pas padisë së bërë nga subjekti i rivlerësimit, me objekt “Detyrimi i palës së paditur të zbatohet efektet e kontratës së sipërmarrjes së datës 3.4.2003, me nr. *** rep., duke njohur paditësin pronar mbi pasurinë e paluajtshme të llojit apartament, që përbëhet nga 2 dhoma e 1 kuzhinë, me sip. 108.31 m², me adresë në rrugën “***”, Tiranë, bazuar në lejen e ndërtimit të

¹⁰ Dosja e ILDKPKI-së, aneks nr. ***, f. ***.

¹¹ Kontratë cedimi të të drejtave të kontratës së sipërmarrjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.3.2016, redaktuar nga noteri publik, znj. V.S.

¹² Dokumenti noterial “Saktësim kontrate”, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.6.2016, redaktuar nga noteri publik, znj. V.S.

miratuar në vendimin nr. ***, datë 26.5.2001, të KRRT-së”, me palë të paditur shoqëria “****” sh.p.k., persona të tretë ZVRPP-ja Tiranë, shoqëria “****” sh.p.k. dhe shoqëria “****” sh.p.k. – në datën 23.12.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur¹³: (a) pranimin e kërkesëpadisë; (b) detyrimin e palës së paditur të zbatojë efektet e kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., datë 3.4.2003, duke njohur paditësin pronar mbi pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament”, që përbehet nga 2 dhoma dhe 1 kuzhinë, me sip. 108.31 m², me adresë rruga “****”, Tiranë, bazuar në lejen e ndërtimit të miratuar me vendimin nr. ***, të Këshillit të Rregullimit të Territorit; si dhe (c) detyrimin e palës së paditur të regjistrojë në regjistrat publikë të ZVRPP-së Tiranë pasurinë e paluajtshme në pronësi të paditësit¹⁴.

v. Në datën 26.4.2017, ZVRPP-ja Tiranë ka lëshuar certifikatën e pronësisë për pasurinë objekt vlerësimi, konkretisht për pasurinë nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e llojit “apartament” me sipërfaqe 96.21 m² dhe sipërfaqe të përbashkët 10.58 m², në emër të shtetasit P.F¹⁵, me shënim në kartelën e pasurisë “leje legalizimi”, ndërsa në seksionin e hipotekave, vendimeve të gjykatave, kufizime etj. të kësaj karteje është shënuar “kufizohen veprimet deri në realizimin e kontratës së shkëmbimit”.

vi. Në vijim rezulton se në datën 21.7.2017, në të njëjtin seksion të kartelës së kësaj pasurie, është shënuar: “...regjistrohet vendimi i gjykatës me nr. *** regj., nr. *** vendimi, datë 27.1.2017, për njohje të pronësisë dhe njohje të efekteve të kontratës së sipërmarrjes me nr. *** rep., datë 3.4.2003, shoqëria “****” sh.p.k. kundrejt z. Naim Tota...”.

vii. Në datën 22.8.2017, është nxjerrë urdhri nr. ***, i regjistruarit të ZVRPP-së Tiranë, në referim të të cilit është urdhëruar regjistrimi në regjistrat publikë i pasurisë së paluajtshme me të dhënat: z. k. ***, vol. ***, f. ***, e llojit “apartament” me sip. 96.21 m², në emër të paditësit Naim Tota. Bazuar në urdhrin e sipërcituar, po në datën 22.8.2017, kjo pasuri është regjistruar në regjistrat hipotekorë në emër të subjektit të rivlerësimit, duke u lëshuar edhe certifikata për vërtetim pronësie nr. ***.

26.8 Ujësjellës Kanalizime Tiranë¹⁶ informon se, në emër të subjektit të rivlerësimit rezulton kontrata nr. ***, për objektin me adresë: rruga “****”, Tiranë, me status “aktiv”, në kategorinë e konsumatorëve familjarë. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga UKT-ja rezulton se, kjo kontratë është lidhur bazuar në certifikatën për vërtetim pronësie nr. ***, lëshuar në datën 22.8.2017, në emër të subjektit të rivlerësimit, për pasurinë objekt vlerësimi.

26.9 Furnizuesi i Shërbimit Universal¹⁷, pjesë e OSHEE Group, informon se, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, në emër të subjektit të rivlerësimit identifikohet kontrata e furnizimit me nr. ***, në instancën Tiranë. Nga verifikimi i dokumentit “detajet e klientit”, të printuar nga sistemi i OSHEE-së, duket se kjo kontratë është e tipit familjar dhe lidhet me adresën e pasurisë objekt vlerësimi. Gjithashtu, rezulton se në datën 11.6.2018 është ndryshuar emri i abonentit për këtë kontratë. Pra, në dukje emri i subjektit të rivlerësimit është regjistruar në datën 11.6.2018 në kontratën e lidhur me OSHEE-në, për furnizimin me energji elektrike të apartamentit objekt vlerësimi.

26.10 Nga verifikimi i informacionit dhe dokumentacionit të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile¹⁸, rezulton se subjekti i rivlerësimit së bashku me familjen e tij është larguar nga Bashkia Kukës për në Njësinë Bashkiake Nr. ***, Tiranë, në datën 30.8.2004, me aktin nr. ***.

¹³ Vendim nr. ***, datë 23.12.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹⁴ Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 27.1.2017, pasi nuk u ankimua.

¹⁵ Në vendimin e gjykatës me të cilin urdhërohet regjistrimi i pasurisë objekt vlerësimi në emër të emër të subjektit të rivlerësimit shpjegohet më në detaje arsyeja e regjistrimit fillestar të kësaj pasurie në emër të shtetasit P.F.

¹⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 21.9.2020, e UKT-së, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 23.9.2020.

¹⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 24.9.2020, e FSHU-së, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 28.9.2020.

¹⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 22.7.2022, e DPGJC-së, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 25.7.2022.

26.11 Pasi Komisioni i kërkoi Zyrës¹⁹ së Gjendjes Civile pranë Njesisë Administrative Nr. *** të Bashkisë Tiranë, informacion për momentin e regjistrimit të subjektit si banor i kësaj njësie, si dhe dokumentacionin e plotë të depozituar prej tij dhe/apo familjarëve të tij mbi bazën e të cilit është kryer regjistrimi si banor i kësaj njësie, kjo zyrë konfirmon se²⁰ subjekti i rivlerësimit është regjistruar familjarisht pranë Njesisë Administrative Nr. ***, në datën 30.8.2004, me adresë rruga “****”, p. ***, shk. ***, ap. ***, ardhur nga Zyra e Gjendjes Civile Kukës. Ndërsa, për dokumentin e adresës, informon se nuk e disponojnë, pasi sipas Vendimit Nr. ***, datë 11.12.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për caktimin e dokumenteve për ndryshimin e vendbanimit”, u vendos që këto dokumente administrohen dhe ruhen nga Zyra e Gjendjes Civile për një periudhë 5-vjeçare.

26.12 Komisioni konstaton se, referuar deklaratimeve të bëra në ILDKPKI, subjekti ka filluar të banojë në këtë pasuri, apartamentin në Tiranë, që prej vitit 2004. Ndërkohë, referuar shpjegimeve të dhëna prej tij në ILDKPKI me anë të “procesverbalit mbi shpjegimet e subjektit të deklaratimit të pasurive”²¹, ka deklaruar se ka filluar të banojë në këtë apartament në vitin 2006. Ndërsa, pasi u pyet nga Komisioni²² mbi adresat e banimit që nga momenti i fillimit të detyrës, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale²³ të datës 24.7.2020, të shtetasve T.H dhe I.H (kunati dhe e motra), në referim të së cilës kanë deklaruar se subjekti dhe familja e tij kanë banuar në apartamentin e tyre (pasuria objekt vlerësimi) prej vitit 2005 e në vijim.

26.13 Pasi Komisioni i kërkoi shpjegime për mospërputhjet e konstatuara në deklaratimet e bëra mbi momentin e fillimit të banimit të familjes së tij në apartamentin e ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit²⁴, subjekti i rivlerësimit ka parashtuar se, *sikurse ka deklaruar në vazhdimësi, ky apartament është marrë në përdorim nga familja e tij në fund të vitit 2004 dhe fillimi i vitit 2005, kjo pasi kanë ndërruar banesën nga rruga “****” në rrugën “****”. Madje, mesa kujton, familja e tij është regjistruar në këtë adresë në gusht të vitit 2004, për shkak të regjistrimit të fëmijëve në shkollë, pasi paraprakisht motra dhe kunati i kishin ofruar të banonte në këtë apartament, në kushtet kur ata kishin një banesë në zonën e ***, Tiranë. Pra, kjo ka qenë pak a shumë historia e fillimit të banimit të familjes së tij në këtë apartament, duke sjellë në vëmendje se në atë periudhë ka qenë i komanduar me punë si prokuror në disa rrethe të Shqipërisë.*

26.14 Për sa u evidentua më sipër, në lidhje me pasurinë objekt vlerësimi, apartament banimi i ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, në kushtet kur duket se: (i) porositi/blerësi fillestar i kësaj pasurie nuk e ka përdorur asnjëherë atë; (ii) subjekti dhe familja e tij e kanë përdorur pa kundërshtim këtë pasuri për një periudhë prej rreth 12-vjeçare; (iii) në kontratën e cedimit të të drejtave, datë 16.3.2016, ndër të tjera, është përcaktuar se: *“Ceduesi deklaroi se pagesat e këtyre 3 kësteve në vlerë totale 50,000 USD, që i ka likuiduar shoqërisë sipërmarrëse, i janë dhënë nga përfituesi”*²⁵; (iv) nga njëra anë subjekti deklaroi se e ka përdorur pa kundërshtim këtë pasuri, ndërkohë, nga ana tjetër, në vitin 2008 i ka dhënë hua me interes shtetasit T. H, i cili i kishte lënë në përdorim këtë pasuri; (v) në kontratën e cedimit të të drejtave përcaktohet i njëjti çmim i paguar nga subjekti (si përfitues) në vitin 2016 me atë të cilin kishte

¹⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 7.11.2022, e Komisionit.

²⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 10.11.2022, e Zyrës së Gjendjes Civile, Njësia Administrative Nr. ***, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 11.11.2022.

²¹ Procesverbal i përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 27.7.2022, e ILDKPKI-së, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 28.7.2022.

²² Pyetësori nr. ***, dërguar nga Komisioni.

²³ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.7.2020, redaktuar nga noteri publik, znj. B.Ç.

²⁴ Referohuni prapësimeve shtesë të depozituara në datën 6.3.2023, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 6.3.2023 (të dërguara edhe në rrugë elektronike me email-in e datës 6.3.2023).

²⁵ Duket se dokumenti “saktësim kontrate”, i datës 7.6.2016, ndërmjet “ceduesit” dhe “përfituesit” të të drejtave, në referencë të të cilit përcaktohet se: *“Ky paragraf është një gabim i bërë prej tyre, pasi 50,000 USD i është dhënë sipërmarrësit nga ceduesi dhe jo nga përfituesi, prandaj në këtë paragraf duhet të hiqet togfjalëshi ‘i dhënë nga përfituesi’, pasi është gabim, u përpilua dhe u nënshkrua vetëm pas mbajtjes së procesverbalit “mbi shpjegimet e subjekti deklarues”, të mbajtur në ILDKPKI në datën 31.5.2016.*

paguar ceduesi në vitin 2003²⁶ – Komisioni ngriti dyshime të arsyeshme se kemi të bëjmë me pasuri të porositur dhe paguar nga subjekti i rivlerësimit që në vitin 2003, me qëllim përdorimin, disponimin dhe gëzimin e plotë nga ana e tij, por se kontrata e porosisë është lidhur në emër të shtetasit T.H, në dukje me qëllim shmangien e kontrollit dhe verifikimit të ligjshmërisë së burimeve të cilat kanë shërbyer për pagesën/pagesat e kryer/a për likuidimin e çmimit të blerjes së saj.

26.15 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit, duke i kërkuar të paraqesë argumentet/shpjegimet përfundimtare, si dhe të depozitojë prova të reja të mundshme mbi konstatimin e mësipërm.

26.16 Në vijim, Komisioni vlerëson se, në kuptim të pikës 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, në kushtet kur rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur lidhje të vazhdueshme interesi me shtetasin T.H, duket se ai kategorizohet në cilësinë e “personit tjetër të lidhur”, kjo në funksion edhe të deklarimit dhe verifikimit të çdo shtate të mundshme të konfliktit të interesit.

26.17 Referuar ligjit nr. 84/2016, si dhe bazuar në jurisprudencën e Kolegjit²⁷, interesi pasuror që i vendos personat e tjerë të lidhur në kushtet e detyrimit për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë është përcaktuar në pikën 4 të nenit 32 të tij, pra se duhet të jetë një marrëdhënie dhurimi, huamarrjeje ose huadhënieje me subjektin e rivlerësimit. Por, kjo nuk mund të cenohet apo të shmangë detyrimin që ka Komisioni për të kryer hetime për çdo pasuri, për të cilën ka të dhëna apo dyshime të arsyeshme se është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, pavarësisht se mbahet në emër të personave të tjerë të lidhur apo shtetasve të tjerë, të cilët nuk kanë asnjë lidhje me subjektin e rivlerësimit, në kuptim të përcaktimeve të nenit 3, pika 14 e këtij ligji.

26.18 Pra, nisur nga fakti i deklarimit të kësaj pasurie në përdorim dhe rrethanave të tjera të referuara nga Komisioni si më sipër, duket se në këtë rast kemi të bëjmë me situatë të dyshuar se personi tjetër i lidhur mund të ketë mbajtur të regjistruar në emrin e tij pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit.

26.19 Në këtë kuadër, në përputhje edhe me jurisprudencën e Kolegjit²⁸, me dërgimin e rezultateve të hetimit Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit, duke i kërkuar të deklarojë të ardhurat e personit tjetër të lidhur T.H, të cilat kanë shërbyer për kryerjen në vitin 2003 të pagesave për porositjen e pasurisë objekt vlerësimi, pavarësisht se në cilësinë e personit tjetër të lidhur duket se nuk është në kushtet e parashikuara në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, por kjo vlerësuar si një rrethanë dhe *indicie* e rëndësishme në verifikim të situatës së dyshuar për fshehje pasurie.

26.20 Sikurse u evidentua edhe më sipër, pas zhvillimit të seancës së parë dëgjimore, shqyrtimit të prapësimeve dhe provave mbështetëse mbi rezultatet e hetimit, si dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti gjatë seancës dëgjimore, trupi gjyqës vendosi riçeljen e hetimit administrativ me qëllim kryerjen e një analize për evidentimin e mundësisë financiare të shtetasit T. H për likuidimin e çmimit të blerjes të pasurisë objekt vlerësimi, apartamenti i ndodhur në rrugën “***”, Tiranë, deri në datën 29.12.2003, pasuri e cila në vijim është përfituar prej subjektit me kontratën e cedimit të vitit 2016.

26.21 Në vijim, pasi Komisioni verifikoi dhe analizoi dokumentacion e depozituar me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit mbi të ardhurat e përfituara nga personi tjetër i lidhur, shtetasi T.H dhe/apo familjarët e tij, përpara kryerjes së pagesave për likuidimin e çmimit të

²⁶ Ndërkohë, referuar Udhëzimit Nr. 3, datë 28.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2016”, duket se sipas vlerës mesatare të banesave në tregun e lirë për zonën ku ndodh pasuria objekt vlerësimi, konkretisht në rrugën “***”, Tiranë, ndërmjet zonës *** dhe *** të Njësisë Administrative Nr. ***, çmimi për metër katror për këto zona varionte nga 132,000 lekë/m² deri në 190,000 lekë/m². Pra, duket se vlera e tregut për këtë apartament në vitin 2016 ishte midis vlerës 12,766,208 lekë dhe 18,390,100 lekë.

²⁷ Shihni paragrafin 74, në faqet 29 dhe 30 të vendimit nr. 21/2020 (JR), datë 10.9.2020, të Kolegjit.

²⁸ Shihni paragrafët 109 dhe 110, në faqet 34 dhe 35 të vendimit të Kolegjit të Apelit, me nr. 15/2019 (JR), datë 17.7.2019.

plotë për apartamentin objekt vlerësimi, kreu analizën e treguesve financiarë me rezervë, nga ku duket se ata nuk kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht likuidimin e çmimit të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi, apartamenti në Tiranë, likuiduar plotësisht deri në datën 29.12.2003.

26.22 Për sa më sipër, me qëllim garantimin e mbrojtjes efektive, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu dërguan rezultatet shtesë të hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës mbi analizën financiare me rezervë, të kryer nga Komisioni, për të dhënë shpjegimet/argumentet e tij përfundimtare, si dhe për të depozituar prova të reja të mundshme mbi të ardhurat e personit tjetër të lidhur T.H dhe/apo familjarëve të tij, të cilat kanë shërbyer si burim për likuidimin e çmimit të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi deri në datën

29.12.2003, analizuar kjo rrethanë si një nga elementet në vlerësimin përfundimtar të situatës së dyshuar për fshehje pasurie.

Qëndrimi i mbajtur nga subjekti i rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe rezultateve shtesë të hetimit administrativ – lidhur me dyshimet e ngritura nga Komisioni mbi këtë pasuri

26.23 Me anë të prapësimeve të depozituara në Komision²⁹, si dhe nëpërmjet shpjegimeve të dhëna gjatë seancave dëgjimore, nisur nga dyshimet e ngritura për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se nuk ka asnjë lidhje me porositjen dhe kryerjen e pagesave në vitin 2003, për apartamentin e ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, pasi referuar provave shkresore del qartë se banesa në fjalë është porositur dhe blerë nga “ceduesi” T. H dhe jo prej tij si “përfitues”, por, gjithashtu, duke theksuar faktin se në asnjë rast nuk ka shmangur deklarin e përdorimit të kësaj banese (përpara blerjes së saj), pasi e ka deklaruar si adresë banimi në ILDKPKI.

26.24 Në këtë kontekst, lidhur me përdorimin e kësaj pasurie, subjekti ka shpjeguar se për shkak të marrëdhënies së posaçme, lidhjes së ngushtë familjare dhe traditës së zonës së tyre, fillimisht familjes së tij i është ofruar banimi pa kundërshtim, situatë kjo që siguron nuk mund të vazhdonte gjatë, por derisa familja e tij të sistemohej në një banesë tjetër. Kështu, me anë të prapësimeve të tij, subjekti sqaron se për shkak të rrethanave familjare, siç ishte fatkeqësia e ndodhur në vitin 2006³⁰, si dhe në vijim të vënies në dijeni të investimit të kryer nga bashkëshortja e tij në shoqërinë “****” sh.a. dhe më pas të dhënies hua të shumës së përfituruar nga kthimi i këtij investimi³¹, pikërisht kunatit të tij, z. T. H, kjo marrëdhënie ka vazhduar pak a shumë në heshtje, përveç përfitimit të disa interesave nga huaja sipas deklarimeve që ka bërë në ILDKPKI.

26.25 Subjekti ka parashtruar se, në deklaratën e vitit 2008 ka referuar se ka banuar me qira në këtë banesë, pikërisht për shkakun se për sa kohë kishte marrë disa interesa huaje nga shtetasi T.H, nuk iu duk e drejtë që të banonte pa qira në apartamentin e tij, duke sqaruar se pas kësaj periudhe shtetasi T.H nuk i ka dhënë interesa për shkak se ai nuk kishte fitime nga biznesi³², si dhe në vijim të situatës shëndetësore që ai u gjend dhe shpenzimeve të kryera në këtë funksion, marrëdhënia vazhdoi e tillë deri në vitin 2016, vit në të cilin bënë marrëveshjen në kontratën për cedimin e të drejtave. Edhe në këtë rast subjekti deklaroi se për shkak të marrëdhënies së posaçme, traditës së zonës, por edhe si rrjedhojë e faktit se shtetasi T.H kishte përdorur për një

²⁹ Prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 20.2.2023 (prapësime të dërguara edhe në rrugë elektronike me *email*-in e datës 20.2.2023); si ehe prapësimet dhe provat shtesë të depozituara nga subjekti, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 6.3.2023 (prapësime të dërguara edhe në rrugë elektronike me *email*-in e datës 6.3.2023).

³⁰ I referohet ndarjes nga jeta të bashkëshortes së tij të ndjerë F.T.

³¹ I referohet investimit të kryer nga bashkëshortja e tij, e ndjera F.T, në vitin 2005, në shoqërinë “****” sh.a., dega Kosovë, kthimit të këtij investimi në vitin 2007 dhe dhënies hua të shumës së përfituruar, bashkëshortit të motrës së tij, z. T.H, çështje të cilat do të trajtohen në vijim të këtij vendimi.

³² Duket se i referohet deklarimeve të dhëna nga vetë shtetasi T.H, se ka ushtruar aktivitetin e këmbimit valutor.

kohë të gjatë shumë 40,000 euro, duke mos i dhënë mbrapsht interesa, ranë dakord që apartamentin do ta jepte me çmimin që ai e kishte blerë vetë.

26.26 Në përfundim të shpjegimeve lidhur me këtë çështje, subjekti ka ritheksuar se kjo pasuri është blerë prej tij, pra se nuk i është e dhuruar nga shtetasi T.H dhe në këtë kontekst argumenton se ky shtetas nuk mund të kategorizohet si person tjetër i lidhur, i cili ka detyrimin për të justifikuar burimin e ligjshëm të pasurisë, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

26.27 Gjithsesi, nisur nga dyshimet e ngritura nga Komisioni, në funksion të gatishmërisë për t'u treguar sa më bashkëpunues, me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit dhe rezultateve shtesë të hetimit, si dhe nëpërmjet shpjegimeve të dhëna gjatë seancave dëgjimore, subjekti referon se ka deklaruar burimin e të ardhurave, si dhe ka depozituar dokumentacionin justifikues ligjor, nga ku duket se shtetasi T.H dhe/apo familjarët e tij kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme, të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht pagesën e kryer gjatë vitit 2003, për shlyerjen e çmimit të blerjes së apartamentit të ndodhur në rrugën “***”, Tiranë.

Analiza e kryer nga Komisioni/vlerësimi përfundimtar i shpjegimeve dhe provave

26.28 Trupi gjykues, pasi shqyrtoi parashtrimet, shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, në funksion të kundërshtimit të situatës së dyshuar për fshehje pasurie, si dhe pasi e dëgjoi në seancë dëgjimore, analizoi të gjitha argumentet dhe provat e paraqitura prej tij në raport dhe harmoni me dokumentacionin e administruar në dosje, mbi çdo rrethanë dhe/apo *indicie* të evidentuar në rezultatet e hetimit kryesisht në konstatimin e situatës së dyshuar për fshehje pasurie. Trupi gjykues, paraprakisht në çështjen objekt vlerësimi konstaton se përgjatë hetimit nuk u evidentua asnjë provë/fakt apo *indicie* që e lidh subjektin e rivlerësimit me porositjen dhe kryerjen e pagesave në vitin 2003, për apartamentin e banimit të ndodhur në rrugën “***”, Tiranë. Në vijim, çmon të analizojë çdo rrethanë të dyshuar, sikurse arsyetohet në vijim:

i. Lidhur me faktin e mospërdorimit të kësaj pasurie nga blerësi fillestar, trupi gjykues çmon se në asnjë rast kjo rrethanë nuk mund të shërbejë si e vetme në ngritjen e situatës së dyshuar për fshehje pasurie. Referuar shpjegimeve të dhëna nga subjekti, por edhe të deklarimeve të bëra para Komisionit nga vetë shtetasi T.H, rezulton se në atë periudhë ai ka pasur të ndërtuar/në ndërtim e sipër një pasuri të paluajtshme të llojit “banesë” në zonën e F, Tiranë, ku ka banuar dhe banon aktualisht. Në këtë kontekst, duket i besueshëm deklarimi i dhënë nga shtetasi T.H se porositjen e këtij apartamenti e ka vlerësuar si një mundësi investimi. Vlen të evidentohet fakti se në vazhdimësi në deklaratat e interesave privatë/periodikë vjetorë të depozituara ndër vite në ILDKPKI, subjekti ka deklaruar si adresë banimi, adresën e cila duket se lidhet me këtë pasuri, fakt të cilin e ka konfirmuar gjatë hetimit administrativ, pra se kemi të bëjmë pikërisht me këtë apartament. Ky deklarim i subjektit në kohë reale çmohet si rrethanë e rëndësishme, që tregon se ai nuk ka shmangur deklaratimet e tij lidhur me këtë apartament banimi, që në një situatë hipotetike do të mund të vlerësohej si përpjekje për të fshehur lidhjet me të.

ii. Lidhur me rrethanën e evidentuar se subjekti dhe familja e tij e kanë përdorur pa kundërshtim këtë pasuri për një periudhë prej rreth 12-vjeçare, Komisioni i gjen bindëse shpjegimet e dhëna nga subjekti mbi faktin e përdorimit të kësaj pasurie pa kundërshtim. Kështu, krahas lidhjes së posaçme familjare, duket se si faktorë të tjerë të rëndësishëm që kanë ndikuar në vazhdimin e përdorimit të kësaj pasurie pa kundërshtim për një periudhë të gjatë kohore kanë shërbyer fatkeqësia e ndodhur në familjen e subjektit në vitin 2006, si dhe marrja hua dhe përdorimi në vazhdimësi dhe pa kundërshtim (pa kthyer interesat sipas marrëveshjes së dakordësuar) i një vlerë të konsiderueshme monetare nga pronari i kësaj pasurie.

iii. Sa i përket përcaktimit të bërë në “deklarimet paraprake” të kontratës së cedimit të të drejtave, të datës 16.3.2016, se: “*Ceduesi deklaroi se pagesat e këtyre 3 kësteve në vlerë totale*

50,000 USD, që i ka likuiduar shoqërisë sipërmarrëse, i janë dhënë nga përfituesi”, në kushtet kur ka prova për të kundërtën, trupi gjykues krijoi bindjen se kemi të bëjmë me një lapsus i cili është korrigjuar me dokumentin noterial “saktësim kontrate”, i datës 7.6.2016, për sa kohë rezulton se edhe vetë në nenin 2 të kontratës së “cedimit” është përcaktuar se vlera totale e kontratës është 50,000 USD, e cila është likuiduar e gjitha nga “përfituesi” të “ceduesi” jashtë zyrës noteriale. Pra, pavarësisht se nuk referohet momenti/periudha konkrete kur është likuiduar kjo shumë, lihet të kuptohet se është kryer para nënshkrimit të kontratës së “cedimit”.

iv. Lidhur me konstatimin e bërë se nga njëra anë subjekti deklaron se e ka përdorur pa kundërshtim këtë pasuri, ndërkohë nga ana tjetër, në vitin 2008, i ka dhënë hua me interes shtetasit T.H, i cili i kishte lënë në përdorim këtë pasuri, për sa u parashtrua edhe më sipër, Komisioni i gjen bindëse shpjegimet e subjektit mbi deklarin e bërë në DIPP-në e vitit 2008 për përdorimin e këtij apartamenti me qira, periudhë e cila përkon me dhënien e huas dhe deklarin e përfitimit të interesave nga kjo marrëdhënie, pikërisht për shkak të lindjes së kësaj marrëdhënieje të re interesi të ndërsjellë, në dukje për të qenë korrekt me detyrimet ndaj njëri-tjetrit. Kështu, rezulton se subjekti ka deklaruar vetëm për një periudhë të shkurtër përfitimin e interesave nga marrëdhënia e huas për disa muaj, që i përkasin viteve 2008 dhe 2009, nga ku duket se për vitin 2009 nuk është deklaruar si i përfituar interesi i plotë sipas marrëveshjes së referuar, për dhënien e shumës prej 40,000 euro në huapërdorje. Në këtë kontekst, siç u evidentua edhe më sipër, në kushtet kur marrëdhënia e huas ka vazhduar pa kthimin e interesave nga huamarrësi T.H, ka logjikë ekonomike fakti i vazhdimit të banimit të subjektit dhe familjes së tij në këtë apartament, pa kundërshtim, situatë sigurisht e vlerësuar edhe në kuadër të lidhjes së posaçme familjare mes tyre.

v. Edhe sa i përket dyshimeve të ngritura mbi çmimin e paguar nga subjekti për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2016, në vijim të arsyetimit të bërë si më sipër, trupi gjykues i gjen bindëse shpjegimet e dhëna nga subjekti mbi përcaktimin e këtij çmimi, fakt ky i vlerësuar përpos lidhjes së posaçme familjare edhe për shkak të lënies në përdorim të vlerës prej 40,000 euro, pa kërkuar interesa. Në këtë prizëm, Komisioni sjell në vëmendje se një pjesë e vlerës prej 40,000 euro, pasuri e evidentuar si e krijuar nga bashkëshortja e ndjerë e subjektit, si rrjedhojë e një investimi të kryer gjatë regjimit martesor, i takonte/takon me trashëgim 3 fëmijëve, të cilët në atë kohë ishin të mitur. Në këtë kontekst, trupi gjykues çmon se sjellja e subjektit në përdorimin e kësaj shume duket se ka qenë në përmbushje të detyrimeve të tij prindërore, pasi sipas vetëdeklarimeve të bëra në një lloj forme, kjo vlerë monetare dhe frytet e pritshme prej saj kanë shërbyer për sigurimin e ambientit të banimit të tyre.

vi. Gjithsesi, përtej këtij arsyetimi, Komisioni çmon të vlerësojë edhe nga pikëpamja substanciale burimin e ligjshëm të të ardhurave, specifikisht verifikimin e mundësisë financiare të familjes H për likuidimin në vitin 2003 të çmimit të blerjes së kësaj pasurie.

Komisioni vëren se nëpërmjet prapësimeve të depozituara dhe shpjegimeve të dhëna gjatë seancave dëgjimore, subjekti i rivlerësimi, në përmbushje të detyrimit të lënë si barrë prove në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, ka deklaruar mbi të ardhurat e familjes H, të cilat referohen se kanë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, në vitin 2003, duke depozituar edhe dokumentacion justifikues ligjor provues në mbështetje të deklarimeve të tij.

26.29 Në përmbledhje të deklarimeve të bëra nga subjekti, rezulton se si burim të ardhurash të familjes H, të cilat kanë shërbyer për blerjen e apartamentit në Tiranë, janë referuar: (i) të ardhurat nga paga dhe komisionet e përfituara nga shtetasi T.H, si i punësuar në sektorin e sigurimeve; (ii) të ardhurat nga puna e motrës së tij, znj. I. H(T), bashkëshortes së shtetasit T.H; (iii) të ardhurat e përfituara nga shitja e dy banesave (njëra së bashku me truallin) në qytetin e Kukësit; si dhe (iv) të ardhurat e përfituara nga shtetasi T.H si rezultat i kryerjes së aktivitetit të këmbimit valutor.

26.30 Subjekti ka depozituar edhe dokumentacionin mbi disponimin e disa vlerave monetare të konsiderueshme në depozita bankare ndër vite nga shtetasi T.H dhe bashkëshortja e tij, të tërhequra plotësisht përpara pagesës së këstit të fundit të çmimit të blerjes së apartamentit në Tiranë.

26.31 Pasi Komisioni verifikoi dhe analizoi dokumentacionin e depozituar me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, mbi të ardhurat nga puna të përfituara nga personi tjetër i lidhur T.H dhe bashkëshortja e tij, znj. I. H, përpara kryerjes së pagesave për likuidimin e çmimit të plotë për apartamentin objekt vlerësimi, rezultuan të dhënat e punësimit dhe të ardhurat nga paga, si vijon: (a) të ardhura të shtetasit T.H nga puna e tij në shoqërinë “****” sh.a., për periudhën 1995 – 1999, në total në shumën 847,765 lekë³³; (b) të ardhura të shtetasit T.H nga puna e tij në shoqërinë “****” sh.a., për periudhën 15.2.2000 – 2003, në total në shumën 1,047,900 lekë³⁴; (c) të ardhura të shtetasit I.H (motra e subjektit, bashkëshortja e shtetasit T.H) nga puna në Bashkinë Kukës, për periudhën 1994 – shtator 2002, në total në shumën 1,042,179 lekë³⁵; si dhe (ç) të ardhura të shtetasit I.H nga puna në njësinë Administrative P, Tiranë, për periudhën 16.9.2002 – 31.12.2003, në total në shumën 260,544 lekë³⁶.

26.32 Pra, rezulton se të ardhurat totale *neto* nga puna e shtetasit T.H dhe bashkëshortes së tij I.H, të provuara me dokumentacionin justifikues ligjor, për periudhën deri në dhjetor të vitit 2003, janë në total në shumën prej rreth 3,200,000 lekësh (3,198,388 lekë). Konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka depozituar edhe dokumentacionin ligjor provues për të dhëna të punësimit të shtetasit T.H për periudhën deri në vitin 1993, në pozicionet e punës si inxhinier, k/brigadier dhe drejtor, por në të cilin nuk evidentohen vlerat e përfituara nga paga³⁷.

26.33 Gjithashtu, me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve shtesë të hetimit, ndër të tjera, subjekti ka paraqitur dy vërtetime të shoqërive të sigurimit “****” sh.a. dhe “****” sh.a.³⁸, me anë të të cilave konfirmohet se krahas pagës shtetasi T.H ka përfutur komisione dhe/apo bonuse shtesë si rezultat i punës së kryer prej tij në këto kompani.

26.34 Kështu, referuar vërtetimit të lëshuar nga shoqëria “****” sh.a., konfirmohet se shtetasi T.H ka përfutur të ardhura edhe nga komisione për polica sigurimi, në cilësinë e personit të marrjes në sigurim dhe se gjatë periudhës që ka qenë i punësuar në këtë kompani pagesat për komisione nuk janë përfshirë në pagë, por paguheshin si të ardhura të tatueshme në burim. Në vijim, shoqëria “****” sh.a. ka referuar se meqenëse politika e shpërblimit të punonjësve të shitjes synonte nxitjen e tyre për rritjen e shitjeve, komisionet që përfitonin punonjësit kanë qenë të konsiderueshme dhe të krahasueshme me pagën mujore³⁹. Ndërsa, referuar vërtetimit të lëshuar nga shoqëria “****” sh.a., konfirmohet se shtetasi T.H ka përfutur bonus për shitjet për çdo periudhë që ka punuar në këtë kompani, por të cilën e kanë të pamundur për ta llogaritur pasi nuk disponojnë të dhëna në arkivë.

26.35 Trupi gjykues vëren se të dhënat e referuara në dy vërtetimet e sipërcituara mbështeten edhe nga deklaratimet e dhëna nga shtetasi T.H, i pyetur në cilësinë e dëshmitarit në datën 9.1.2023, në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Kështu, në dëshminë e tij, ky shtetas ka deklaruar se gjatë kohës që ka punuar në kompaninë e sigurimit, krahas pagës, ka përfutur edhe komisione të cilat ishin në vlera të konsiderueshme.

³³ Vërtetim nr. *** prot., datë 27.12.2022, i DRSSH-së Kukës.

³⁴ Vërtetim nr. *** prot., datë 27.12.2022, i DRSSH-së Kukës; vërtetim nr. *** prot., datë 1.2.2023, i shoqërisë “****” sh.a.

³⁵ Vërtetim nr. *** prot., datë 6.2.2023, i DRSSH-së Kukës; vërtetim nr. *** prot., datë 6.2.2023, i DRSSH-së Kukës; vërtetim nr. *** prot., datë 6.2.2023, i DRSSH-së Kukës; vërtetim për bazën e vlerësueshme, lëshuar nga Bashkia Kukës për të siguruarën I.H, për periudhën janar 2000 – shtator 2002.

³⁶ Vërtetim për bazën e vlerësueshme, lëshuar nga Njësia Administrative Paskuqan, për të siguruarën I. H, për periudhën 16.9.2002 – 30.10.2007.

³⁷ Vërtetim nr. *** prot., datë 2.2.2023, i DRSSH-së Kukës.

³⁸ Vërtetim nr. *** prot., datë 1.3.2023, i shoqërisë “****” sh.a. dhe vërtetim nr. *** prot., datë 8.2.2023, i shoqërisë “****” sh.a.

³⁹ Sipas shoqërisë “****” sh.a., meqenëse në kompani nuk disponohen dhe nuk mund të ofrohen dokumente për atë periudhë, këtë vërtetim e mbështet në standardin dhe analizën e situatës së atëhershme financiare të kompanisë.

26.36 Në analizë të provave të sipërcituara, në harmoni me deklaratimet e bëra nga subjekti, si dhe nisur nga rrethana e vlerësuar se përbën “fakt të njohur botërisht”, përfitimi i komisioneve dhe/apo i bonuseve nga agjentët e punësuar në këto kompani, si rezultat i shitjes së policave të sigurimit⁴⁰, trupi gjykues krijoi bindjen se shtetasi T.H ka përfituar të ardhura shtesë nga komisionet/bonuset, si rezultat i punës së kryer në shoqëritë e sipërcituara. Në kushtet kur duket se totali i të ardhurave nga paga të përfituara nga shtetasi T.H, si rezultat i punës së kryer në kompanitë e sigurimit deri në fund të vitit 2003, ka qenë në shumën prej rreth 1,900,000 lekësh (rreth 1,050,000 lekë nga shoqëria “***” sh.a. dhe 850,000 lekë nga shoqëria “***” sh.a.), si dhe nisur nga e dhëna e referuar në vërtetimin e shoqërisë “****” sh.a. se të ardhurat e përfituara prej komisioneve kanë qenë të krahasueshme me vlerën e pagës, Komisioni çmon se ky shtetas mund të ketë përfituar të ardhura nga bonuset dhe/apo komisionet për këtë periudhë vlerë të përafërt apo më të lartë se shuma prej 1,000,000 lekësh.

26.37 Sillet në vëmendje këtu se, subjekti i rivlerësimit pretendon se shtetasi T.H ka përfituar të ardhura të konsiderueshme edhe si rezultat i ushtrimit të aktivitetit të këmbimit valutor, rrethanë e pasqyruar edhe nga ky shtetas në dëshminë e dhënë para Komisionit, i cili ka deklaruar se e ka kryer këtë aktivitet në qytetin e Kukësit, si subjekt i palicensuar dhe i paregjistruar në organin tatimor në periudhën e zhvillimit të luftës në Kosovë e në vijim. Por, Komisioni çmon se ky pretendim mbetet i karakterit deklarativ.

26.38 Si burim tjetër të ardhurash, të cilat kanë shërbyer për blerjen nga familja H të apartamentit, të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, subjekti ka deklaruar se kanë shërbyer edhe të ardhurat e përfituara prej tyre si rezultat i shitjes së dy pasurive të paluajtshme, të ndodhura në qytetin e Kukësit. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje, rezulton se: (a) me anë të kontratës së shitjes⁴¹ datë 5.8.2002, shtetasi T.H, nëna dhe bashkëshortja e tij kanë shitur pasurinë e llojit “apartament banimi”, të ndodhur në qytetin e Kukësit, me sip. 85 m², për çmimin 1,000,000 lekë; (b) me anë të kontratës së shitjes⁴² datë 4.12.2003, shtetasi T.H ka shitur pasurinë e llojit “banesë njëkatëshe” me sip. 96 m² dhe truall me sip. 240 m², për çmimin 1,000,000 lekë.

26.39 Nëpërmjet prapësimeve të depozituara pas dërgimit të rezultateve shtesë të hetimit dhe shpjegimeve, të dhëna në seancën dëgjimore të datës 8.3.2023, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se vlera reale e shitjes së apartamentit me sip. 85 m² ka qenë rreth 2,500,000 lekë, ndërsa vlera reale e shitjes së banesës me sip. 96 m² dhe truallit prej 240 m² ka qenë 2,800,000 lekë.

26.40 Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti ka depozituar si prova dokumentet: (a) raport vlerësimi, datë 2.3.2023, për apartamentin me sip. 85 m², për vlerësimin e tij në vitin e shitjes 2002; (b) raport vlerësimi, datë 2.3.2023, për banesën me sip. 96 m² dhe truallin me sip. 240 m², për vlerësimin e tyre në vitin e shitjes 2003⁴³; (c) shkresën e Entit Kombëtar të Banesave⁴⁴, datë 28.2.2023; si dhe (ç) deklaratën noteriale të shtetasve T.H dhe S.D⁴⁵.

26.41 Nga analizimi i këtyre provave të depozituara nga subjekti, Komisioni vëren se në punimin e raporteve të vlerësimit të këtyre pasurive ekspertët i janë referuar çmimeve mesatare të tregut të lirë për këtë periudhë në qytetin e Kukësit, bazuar në informacionin e marrë nga Enti Kombëtar i Banesave, si dhe të dhënave të tjera të përfituara nga verifikimi në vend i tyre.

⁴⁰ Në atë periudhë duket se nuk ka qenë e rregulluar specifikisht kuadri ligjor mbi rolin e agjentëve dhe mënyrën e deklaratimit të të ardhurave të përfituara prej tyre si rezultat i përfitimit të komisioneve nga shitjet e kryera. Kështu, duket se në atë periudhë agjentët kanë qenë të punësuar të kompanive të sigurimit, ndërsa sot në cilësinë e rishitësve regjistruar si tatimpagues në organin tatimor (si subjekt tregtar me NIPT më vete) dhe deklarojnë të ardhurat nga komisionet.

⁴¹ Kontratë shitjeje apartamenti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.8.2002.

⁴² Kontratë shitblerjeje për pasurinë e paluajtshme me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.12.2003.

⁴³ Dokumenti raport vlerësimi, përgatitur dhe punuar nga inxhinierët vlerësues të licensuar, z. B. B (vlerësues i shkallës së parë, me nr. lic. ***) dhe znj. E.S (vlerësuese e shkallës së parë, nr. lic. ***), si dhe ekonomiste, eksperte fiskale - kontabël dhe eksperte vlerësuese e pasurive të paluajtshme, znj. E. M (vlerësuese e shkallës së dytë, me nr. lic. ***).

⁴⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 28.2.2023, e EKB-së.

⁴⁵ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.3.2023.

Referuar shkresës së EKB-së, të depozituar si provë nga subjekti, vlera mesatare e apartamenteve në tregun e lirë për qytetin e Kukësit, në vitin 2002, është 28,994 lekë/m² për sipërfaqe shfrytëzimi, referuar tabelës nr. 2, miratuar me UKM-në nr. 3, datë 16.10.2002, ndërsa për vitin 2003, është 27,505 lekë/m² për sipërfaqe shfrytëzimi, referuar tabelës nr. 2, miratuar me UKM-në nr. 1, datë 8.5.2003.

26.42 Për sa më sipër, ekspertët kanë përcaktuar se vlera e apartamentit me sip. 85 m², në vitin 2002, ka qenë 2,464,490 lekë, ndërsa vlera e banesës me sip. 96 m² dhe truallit prej 240 m² ka qenë 3,238,176 lekë.

26.43 Gjithsesi, rezulton se pala shitëse dhe pala blerëse e banesës me sip. 96 m² dhe truallit prej 240 m² (shtetasit T. H dhe S.D), me deklaratën noteriale të datës 1.3.2023, kanë pranuar se si çmimi real i shitblerjes së kësaj pasurie në vitin 2003 ka qenë vlera 2,800,000 lekë, e cila deklarohet se i është dhënë shitësit nga blerësi.

26.44 Në vlerësim përfundimtar të provave dhe shpjegimeve të depozituara nga subjekti, Komisioni krijoi bindjen se pasuritë e sipërcituara janë shitur me një çmim më të lartë nga ai i referuar në kontratat e shitblerjes së tyre dhe se, bazuar në vlerën e tregut të lirë për periudhën kur ato janë shitur, vlera totale e shitjes së tyre mund të ketë qenë mbi 5,000,000 lekë, kjo pasi çmon se raportet e vlerësimit të përgatitur nga ekspertët e licensuar mbështeten në të dhëna lehtësisht të aksesueshme në burime të hapura, konkretisht në udhëzimet e Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive, të vlerave në tregun e lirë të banësive dhe të koeficientit ‘K’⁴⁶”.

26.45 Në vijim të arsyetimit, trupi gjykues çmon se një tjetër *indicie* e rëndësishme, e cila mbështet deklaratimet dhe provat e depozituara nga subjekti mbi vlerën e shitjes së këtyre pasurive nga familja H, përbën fakti se në kontratën e shitblerjes të vitit 2002, për apartamentin e ndodhur në Kukës, të lidhur mes subjektit të rivlerësimit dhe Drejtorisë Rajonale të EKB-së, Kukës, çmimi i shitjes është përcaktuar në shumën 2,640,252 lekë.

26.46 Për sa më sipër, subjekti ka pretenduar se ka provuar se familja H ka pasur të ardhura të konsiderueshme, të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht pagesën e kryer gjatë vitit 2003 për blerjen e apartamentit në Tiranë. Në këtë kontekst, në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti ka depozituar edhe aktekspertimin kontabël⁴⁷, të datës 4.3.2023, në referim të të cilit, bazuar në rrethanat dhe provat e reja të referuara si më sipër, në kundërshtim të analizës financiare me rezervë, e dërguar nga Komisioni me dërgimin e rezultateve shtesë të hetimit, pasqyrohet se, familja H ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht blerjen në vitin 2003 të apartamentit në Tiranë.

26.47 Gjithashtu, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka depozituar në cilësinë e provës, dokumentacion bankar, në referim të të cilit evidentohet disponimi i gjendjeve të konsiderueshme të vlerave monetare nga shtetasi T.H dhe bashkëshortja e tij për periudhën para blerjes së apartamentit në Tiranë.

26.48 Kështu, referuar informacionit/dokumentacionit të administruar nga “Raiffeisen Bank”⁴⁸, rezulton se shtetasi T. H ka pasur një llogari dyemërore së bashku me shtetasen I. H, hapur në Bankën e Kursimeve, dega Kukës, në datën 12.1.2001, në shumën 253,284 lekë, në të cilën janë kryer disa depozitime të tjera *cash* dhe shuma e akumuluar deri në datën 30.1.2002, në vlerën 1,595,820 lekë, është transferuar në Bankën e Kursimeve, dega Tiranë. Në vijim të verifikimit të kësaj llogarie, rezulton se në datën 2.4.2002 është tërhequr shuma 1,100,000 lekë dhe në datën 2.8.2002 është tërhequr shuma 472,275 lekë. Kjo depozitë është mbyllur

⁴⁶ Referohuni qëndrimit të mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelitimit në vendimin nr. 20/2022 (JR).

⁴⁷ Përgatitur nga kontabël i miratuar, z. E. S, pajisur me licencë nr. *** dhe NIPT ***.

⁴⁸ Shkresat nr. *** prot., datë 17.2.2023 dhe nr. *** prot., datë 3.3.2023, të “Raiffeisen Bank”.

përfundimisht në datën 3.6.2003 nga ana e klientit T.H, duke u tërhequr edhe shuma e fundit prej 52,946 lekësh.

26.49 Gjithashtu, rezulton se në datën 6.8.2002, shtetasi T.H ka çelur depozitën e kursimit në Bankën e Kursimeve, dega Kukës, në shumën 1,900,000 lekë. Kjo depozitë, në të njëjtën ditë është transferuar Bankën e Kursimeve, dega Tirana ***, Agjencia nr. ***. Në vijim të verifikimit të kësaj llogarie depozitë, Komisioni konstaton se ajo është mbyllur në datën 3.6.2003 nga ana e klientit T.H, duke u tërhequr shuma e akumuluar prej 2,012,462 lekësh.

26.50 Komisioni vëren se shuma 1,900,000 lekë është depozituar në bankë nga shtetasi T.H vetëm 1 ditë pas shitjes së apartamentit të banimit me sip. 85 m², të ndodhur në Kukës, vlerësuar kjo si një *indicie* shtesë se kjo pasuri mund të jetë shitur me vlerë më të lartë nga çmimi i përcaktuar në kontratë.

26.51 Ndërsa, referuar dokumentit “lëvizje llogarie”⁴⁹ të shtetasit T.H, në “ProCredit Bank”, konfirmohet se ky shtetas në datën 11.6.2003 ka hapur llogarinë depozitë në monedhën dollarë amerikanë (USD) dhe ka depozituar në po të njëjtën ditë shumën prej 20,200 USD, duke e investuar në depozitë me afat. Në vijim të verifikimit të kësaj llogarie, rezulton se në datën 5.11.2003 ka depozituar në këtë llogari shumën 3,500 USD dhe në datën 18.11.2003 ka depozituar shumën 1,500 USD. Këto vlera monetare të ndodhura në llogari depozite së bashku me interesat bankare të përfituara, konkretisht në total në shumën 25,273 USD, janë tërhequr në datën 22.12.2003.

26.52 Në analizë të këtyre të dhënave bankare, krahas evidentimit të disponimit të vlerave monetare nga familja H në sistemin bankar, Komisioni vëren se ka tërheqje të këtyre vlerave para pagesës së kësteve për likuidimin e çmimit prej 50,000 USD, për blerjen e apartamentit të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë.

26.53 Në shqyrtim dhe analizë të shpjegimeve, provave dhe rrethanave të evidentuara mbi të ardhurat dhe burimet financiare të familjes H, trupi gjykues vlerëson se ata kanë pasur një situatë të shëndetshme financiare, pra se ka pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e kryer gjatë vitit 2003 për likuidimin e çmimit të blerjes së apartamentit në Tiranë. Ky konkluzion sigurisht që duhet pranuar se është arritur në kushtet e një niveli më të ulët provueshmërie, për sa kohë shtetasi T.H nuk bën pjesë në rrethin e personave të lidhur, sipas parashikimit të bërë në pikën 13 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, apo në rrethin e personave të tjerë të lidhur, në kuptim të nenit 32/4 të po këtij ligji dhe, si rrjedhojë, nuk kërkohet që të përmbushet detyrimi kushtetues për justifikimin e ligjshmërisë së pasurive, sipas nenit D/3 të Aneksit të Kushtetutës, duke sjellë në vëmendje këtu se analizimi i burimeve financiare të familjes H për blerjen e kësaj pasurie është kryer në funksion të verifikimit të situatës së dyshuar për pasuri të fshehur.

26.54 Në këto kushte, Komisioni arriti në konkluzionin se, për shkak të fakteve dhe rrethanave specifike të trajtuara si më sipër, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit konsiderohen të besueshme dhe bindëse, për sa kohë në mungesë të provës së kundërt e gjithë dinamika e veprimeve të kryera me këtë pasuri në raport me deklaratimet e tij ndër vite dhe ato të bëra në deklaratën *Vetting*, zbehin rrethanat dyshuese të ngritura gjatë hetimit.

26.55 Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se, përpos dyshimeve të ngritura përgjatë hetimit administrativ, nuk u verifikuan apo provuan fakte dhe/ose rrethana që mund të çonin përtej çdo dyshimi të arsyeshëm në një konkluzion të bazuar për fshehjen e kësaj pasurie nga ana e subjektit, që mund ta vendosnin këtë të fundit në kushtet e parashikuara nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës. Kjo situatë faktiko-ligjore, e gërshetuar edhe me faktin se subjekti i rivlerësimit ka kryer të gjitha përpjekjet e mundshme për qartësimin e situatave dhe dinamikave

⁴⁹ Vërtetuar njësimi me origjinalin me dokumentin noterial nr. *** rep., datë 18.2.2023, redaktuar nga noteri publik, z. L.D.

të lartpërshkruara, parë nën dritën e parimit të objektivitetit, nuk krijon një bazë të qenësishme provuese, e cila të mund të tregojë tej çdo dyshimi të arsyeshëm apo të krijojë bindjen se kemi të bëjmë me pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit.

26.56 Për sa më sipër, në vlerësim përfundimtar të të gjitha shpjegimeve, provave, rrethanave dhe *indicieve* të evidentuara lidhur me pasurinë objekt vlerësimi, apartamentin e ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, trupi gjykues konkludon se subjekti nuk gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

26.57 Verifikimi/analizimi i të ardhurave të cilat janë deklaruar nga subjekti si burim për krijimin e pasurisë objekt vlerësimi, apartamenti i ndodhur në Tiranë

a. Të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në Kukës

Rezulton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, subjekti ka deklaruar pasurinë e llojit “apartament banimi (3+1)”, blerë në datën 9.12.2002, nga EKB-ja Kukës, me vlerë 2,640,252 lekë. Si burim të ardhurash për blerjen e kësaj pasurie subjekti ka deklaruar në mënyrë kronologjike sa vijon: (i) nga vlera e apartamentit i është zbritur shuma prej 739,260 lekësh, pasi ka përfitur nga ligji nr. 8467, datë 24.7.2000 “Mbi statusin e të pastrehëve”; (ii) diferencën tjetër të mbetur prej 1,799,444 lekësh e ka paguar me të ardhurat dhe kursimet e tij ndër vite, shlyerja e kredisë së marrë prej tij, pas pagesave periodike për 11 vjet; (iii) 30% e vlerës së mbetur i është ulur për shkak të pagesës së menjëhershme që ka bërë. Diferenca e mbetur sipas zbritjeve si më lart është paguar prej tij me të ardhurat dhe kursimet ndër vite, duke u shlyer me kontratën përfundimtare, datë 24.5.2013.

Komisioni konstaton se në deklaratën fillestare të pasurisë⁵⁰ (dorëzuar në ILDKPKI në mars të vitit 2004), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se zotëron pasurinë nr. ***, me datë regjistrimi në hipotekë nr. ***, datë 9.12.2002, të llojit “apartament banimi”, ndërtuar para vitit 1990, me vlerë 2,640,252 lekë, ndodhur në Lagjen Nr. ***, pallati nr. ***, shkalla nr. ***, Kukës. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar kredinë e marrë nga EKB-ja Kukës. Gjithashtu ka deklaruar se zotëron 100% pjesë takuese të kësaj pasurie. Ndërsa, në seksionin e kësaj deklarate (formulari ***) “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti ka deklaruar kredinë në vlerën 1,799,444 lekë, marrë nga EKB-ja Kukës, për blerje shtëpie banimi (kredi e marrë për strehim).

Në DIPP-në e vitit 2013, në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, subjekti ka deklaruar se ka shitur apartamentin e banimit në Kukës, të deklaruar më parë në ILDKPKI, për vlerën 5,309,500 lekë, duke deklaruar gjithashtu shtesën e likuiditeteve *cash* për vitin 2013, me burim të ardhurat nga shitja e këtij apartamenti, në vlerën 4,400,000 lekë. Gjithashtu konstatohet se shuma e përfitur nga shitja e apartamentit në vlerën 5,309,500 lekë është deklaruar nga subjekti edhe në seksionin e të ardhurave. Ndërsa, në seksionin “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” të kësaj deklarate, subjekti ka deklaruar shlyerjen e kredisë bankare në EKB, në shumën 869,000 lekë, me të ardhurat e deklaruara më parë dhe më pas të zëvendësuara nga shitja e apartamentit.

Pasi Komisioni verifikoi dhe analizoi informacionin/dokumentacionin e administruar në dosjen e hetimit administrativ⁵¹, për mënyrën e fitimit të kësaj pasurie dhe burimin e krijimit të saj, rezultoi se:

⁵⁰ Deklaratë e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie.

⁵¹ Dokumentacion i depozituar nga subjekti i rivlerësimit me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting* (ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së) dhe ai i depozituar bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. ***, të dërguar nga Komisioni.

i. Subjekti i rivlerësimit ka fituar statusin e të pastrehut⁵² sipas vendimit nr. ***, datë 3.12.1992, të Këshillit Bashkiak Kukës.

ii. Në datën 9.12.2002, subjekti i rivlerësimit, bashkëshortja e tij, e ndjera F.T, motra e tij, M.T (D) dhe prindërit e tij, N.T dhe B.T, kanë blerë⁵³ nga Drejtoria Rajonale e Entit Kombëtar të Banesave Kukës, pasurinë e llojit “apartament banimi” në bashkëpronësi, të pandarë, me sip. 129.5 m², sipërfaqe të shfrytëzueshme 76.8 m², me nr. pasurie ***, të ndodhur në katin e ***, shkalla nr. ***, banesa nr. ***, apartamenti nr. ***, Lagjja Nr. ***, Kukës, për vlerën 2,640,252 lekë.

Në seksionin e kontratës, me titull “Vlera e apartamentit dhe çmimi i shitjes”, është përcaktuar se blerësit i takon shuma e përfitimit falas në bazë të ligjit nr. 8647, datë 24.7.2000, prej 739,260 lekësh. Gjithashtu është referuar fakti se blerësi ka paguar në datën e lidhjes së kontratës vlerën 101,548 lekë⁵⁴, ndërsa për shlyerjen e vlerës së plotë të apartamentit blerësit i mbetet të shlyejë detyrimin prej 1,799,444 lekësh⁵⁵, me afat shlyerjeje 25 vjet, me interes 0%.

Në seksionin e kontratës me titull “Parapagimi i kredisë” është përcaktuar se blerësi mund të bëjë pagesën e menjëhershme të vlerës totale të mbetur të kredisë në çdo moment, duke përfituar një zbritje prej 30% të vlerës së mbetur.

Komisioni konstaton se babai i subjektit të rivlerësimit figuron si nënshkrues në kontratën e lidhur me EKB-në Kukës në datën 9.12.2002, ndërkohë që rezulton se ai ka ndërruar jetë në vitin 1995.

I pyetur nga Komisioni lidhur me këtë fakt⁵⁶, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: “...kontrata për blerjen e apartamentit është hartuar kryesisht nga zyra e noterisë Kukës, duke u mbështetur në certifikatën e përbërjes familjare të të pastrehëve, ku në pjesën hyrëse e ka vënë vetëm atë si blerës, në cilësinë e përfaqësuesit të familjes së të pastrehëve, ndërkohë që në fundin e kontratës ka cituar si blerës jo vetëm atë si përfaqësues, por të gjithë familjarët e të pastrehëve, duke marrë edhe nënshkrimet përkatëse të këtyre të fundit. Ai e di që ka nënshkruar vetëm në emrin e tij, ndërsa për personat e tjerë të familjes të të pastrehëve nuk e di në çfarë rrethanash i ka marrë nënshkrimet e tyre”.

iii. Në datën 25.3.2013, subjekti i rivlerësimit ka depozituar *cash*⁵⁷ në llogari bankare, në favor të Drejtorisë Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave Kukës, vlerën prej 869,000 lekësh, me përshkrimin “Naim Tota derdh në llogari shumë”.

iv. Në datën 16.4.2013, me vendimin⁵⁸ nr. ***, të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për lëshimin e trashëgimisë të të ndjerës F.T, e cila kishte ndërruar jetë në datën 20.6.2006, është vendosur të njihen si trashëgimtarë ligjorë të saj subjekti i rivlerësimit dhe tre fëmijët e tyre E, E dhe B. T, përkatësisht me nga ¼ pjesë takuese të pasurisë trashëgimore.

⁵² Vërtetim nr. *** prot., datë 25.10.2016, lëshuar nga DPEKB-ja (ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së, faqe ***).

⁵³ Kontratë shitjeje me këste me kusht, me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.12.2002, redaktuar nga noteri publik, znj. V.B (ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së, faqe ***).

⁵⁴ Bashkëlidhur në këtë kontratë gjendet mandatarkëtimi në favor të DREKB-së Kukës, me nr. ***, datë 9.12.2002, në vlerën 101,548 lekë, me përshkrimin “Naim Tota, arkëtuar 4%, apartamenti 3+1 me kredi”.

⁵⁵ Vlera 1,799,444 lekë, e cila është dhënë në formë kredie, vjen si diferencë e çmimit fillestar prej 2,640,252 lekësh minus zbritja e kryer sipas ligjit nr. 739,260 lekë, minus vlera e paguar *cash* prej 101,548 lekësh nga pala blerëse në datën e lidhjes së kontratës së shitjes.

⁵⁶ Pyetësori nr. ****, dërguar nga Komisioni.

⁵⁷ Mandatdepozitimi *cash* i shumës 869,000 lekë nga subjekti i rivlerësimit në llogarinë e DREKB-së Kukës në Raiffeisen Bank”, ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së, faqe ***.

⁵⁸ Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. ***, “Për lëshimin e trashëgimisë të të ndjerës F.T”, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së.

v. Në datën 24.5.2013, subjekti i rivlerësimit ka blerë⁵⁹ nga Drejtoria Rajonale e Entit Kombëtar të Banesave Kukës, pasurinë e llojit “apartament banimi” në bashkëpronësi, me strukturë 3 dhoma e 1 kuzhinë, me sipërfaqe ndërtimi 129.5 m², sipërfaqe shfrytëzimi, si dhe nga 76.8 m² me pjesën e përbashkët, me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, të ndodhur në Kukës. Në këtë kontratë referohet vlera fillestare e pronës prej 2,640,252 lekësh, e cila rezulton se është shlyer nga shumatorja e disa vlerave, përkatësisht: (a) vlera e përfituar prej 739,260 lekësh si zbritje në bazë të ligjit nr. 8647, datë 24.7.2000 “Mbi statusin e të pastrehëve”; (b) shuma prej 101,548 lekësh si parapagim i kryer nga subjekti; (c) vlera e përfituar prej 30% të shumës së mbetur të pashlyer ende nga kredia në datën e shitjes së pasurisë, konkretisht prej 372,433 lekësh; (ç) pagesat e kryera gjatë viteve nga subjekti në vlerën 1,427,011 lekë, ku përfshihet edhe vlera prej 869,000 lekësh e depozituar *cash* nga subjekti në vitin 2013. Kjo mënyrë likuidimi është konfirmuar edhe nga Drejtoria Ekonomike e Drejtorisë së Përgjithshme të Entit Kombëtar të Banesave⁶⁰.

vi. Në datën 10.6.2013 është lëshuar certifikata për vërtetim pronësie, në referim të të cilit është regjistruar në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit, nënës, motrës dhe fëmijëve të tij pasuria e llojit “apartament banimi” me sip. 129.5 m². Referuar këtij dokumenti, rezulton se subjekti zotëron 17.9% pjesë takuese të kësaj pasurie, i biri E.T 17.9%, e bija E.T 17.8%, i biri B. T 17.8%, e ëma N. T 14.3% dhe e motra M.T 14.3%. Në po të njëjtën datë figuron se prona është rivlerësuar në vlerën 5,309,500 lekë.

Bazuar në vetëdeklarimet e bëra, si dhe në dokumentacionin e administruar në dosje, Komisioni kreu analizën financiare me qëllim evidentimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur për kryerjen në dhjetor të vitit 2002 të pagesës prej 101,548 lekësh, në funksion të blerjes së apartamentit në Kukës, nga ku rezultoi se ata kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht kryerjen e saj⁶¹.

Gjithashtu, referuar dokumentacionit të administruar në dosje, rezulton se përgjatë viteve 2003 – 2012 subjekti ka likuiduar në favor të EKB-së Kukës për çdo vit vlerën prej 55,801 lekësh, në funksion të pagesës së kësteve për blerjen e apartamentit në Kukës. Komisioni konstaton se në vijimësi në deklaratat e interesave privatë/periodikë vjetorë, subjekti ka deklaruar pagesa të shlyera në favor të EKB-së.

Në vijim, rezulton se në datën 25.3.2013, subjekti i rivlerësimit ka shlyer në mënyrë të plotë dhe të parakohshme detyrimin e mbetur ndaj EKB-së Kukës, për blerjen e apartamentit në Kukës, duke paguar shumën 869,000 lekë. Lidhur me kryerjen e kësaj pagese, duket se subjekti ka deklaruar se si burim për shlyerjen e saj kanë shërbyer kursimet e tij të krijuara ndër vite, të deklaruara më parë në ILDKPKI⁶².

Nga verifikimi i deklaratave të interesave privatë/periodikë vjetorë, të depozituara nga subjekti në ILDKPKI, Komisioni konstaton se: (i) në deklaratën fillestare të pasurisë (deklarata e interesave privatë e vitit 2003), subjekti ka deklaruar gjendje likuiditetesh *cash* në shumën 350,000 lekë; (ii) në DIPP-në e vitit 2004, subjekti ka deklaruar shtesë likuiditetesh *cash* në shumën 150,000 lekë; (iii) në DIPP-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar shtesë likuiditetesh *cash* në shumën 500,000 lekë; (iv) në DIPP-në e vitit 2006, subjekti ka deklaruar shtesë likuiditetesh *cash* në shumën 500,000 lekë; (v) në DIPP-në 2007, subjekti ka deklaruar shtesë likuiditetesh *cash* në shumën 400,000 lekë; (vi) në DIPP-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar shtesë likuiditetesh *cash* në shumën 100,000 lekë dhe 3,000 euro; (vii) në DIPP-në e vitit 2009

⁵⁹ Kontratë shitjeje me pagesë të menjëhershme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.5.2013, redaktuar nga noteri publik, z. A.E.

⁶⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 25.10.2016, e EKB-së, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së.

⁶¹ Referohuni tabelës përmbledhëse të analizës financiare, aneksi nr. ***, pjesë e këtij vendimi.

⁶² Referohuni deklaratës së interesave privatë/periodikë vjetorë të vitit 2013, të depozituar nga subjekti në ILDKPKI.

duket se subjekti ka deklaruar shtesë likuiditetesh *cash* në shumën 4,800 euro; (viii) për vitet 2010 – 2012 nuk ka deklaruar shtesë apo pakësim të likuiditeteve *cash*.

Pra, bazuar në vetëdeklarimet e subjektit, duket se në fund të vitit 2012, ai dispononte gjendjen e likuiditeteve *cash* në shumat 2,000,000 lekë dhe 7,800 euro, të cilat rezultojnë se janë të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht pagesën e kryer në datën 25.3.2013, në shumën 869,000 lekë, për likuidimin e çmimit të blerjes të apartamentit në Kukës.

Por, nga ana tjetër, referuar analizës financiare paraprake të kryer nga Komisioni, duket se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të evidentuara për vitet 2004, 2005, 2006, 2007, 2009 dhe 2011, ku përfshihet edhe krijimi i likuiditeteve gjendje *cash*.

Pas shqyrtimit dhe analizimit të shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit me dërgimin e prapësimeve mbi rezultatet e analizës financiare paraprake, në vlerësim të tyre, Komisioni reflektoi ndryshimet përkatëse, nga ku rezultoi se referuar analizës financiare përfundimtare për vitet 2004, 2005, 2006, 2007 dhe 2009 paraqiten me balancë negative fondesh, për një total prej 1,577,274 lekësh⁶³.

Pra, edhe nëse do të merret e mirëqenë se rezultatet negative të evidentuara në vite do të ndikojnë drejtpërdrejt në mundësinë e shtesës së likuiditeteve *cash* të deklaruara për çdo vit, si e vetmja pasuri e cila nuk provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se ka qenë e disponuar nga subjekti i rivlerësimit në fund të çdo viti, pasi nuk është pasuri e materializuar/regjistruar në llogari bankare apo regjistra publikë dhe as e evidentuar/verifikuar/kontrolluar fizikisht nga autoritetet publike, gjithsesi diferenca mes vlerës së vetëdekluarur si gjendje *cash* në fund të vitit 2012 dhe vlerës totale të balancës negative të fondeve është më e madhe se shuma e paguar nga subjekti në datën 25.3.2013, për likuidimin e parakohshëm të çmimit të blerjes së apartamentit në Kukës.

Si rrjedhim, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e kryer në datën 25.3.2013, në shumën 869,000 lekë, për likuidimin përfundimtar të çmimit të blerjes së apartamentit në Kukës. Ky përfundim mbështetet edhe në faktin se nuk evidentohen investime të bëra, shtesa pasurie apo shpenzime të qenësishme të kryera në periudhën 1.1.2013 – 25.3.2013.

Në vijim të verifikimeve të kryera, rezulton se në datën 13.6.2013, subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij⁶⁴ kanë shitur⁶⁵ apartamentin e ndodhur në Kukës, për vlerën 5,309,500 lekë, e cila deklarohet se është likuiduar *cash* jashtë zyrës noteriale.

Komisioni konstaton se subjekti ka deklaruar se ka përfituar shumën e plotë nga shitja e kësaj pasurie, ndërkohë, nga ana tjetër, referuar dokumentacionit ligjor të regjistrimit të kësaj pasurie në ZVRPP-në Kukës, krahas fëmijëve të tij, nëna dhe motra e subjektit, në cilësinë e bashkëpronarëve, zotëronin në total 28.6% pjesë takuese të saj.

⁶³ Referohuni tabelës përmbledhëse të analizës financiare, aneks nr. ***, pjesë e këtij vendimi, rezultatet e së cilës janë reflektuar në përputhje me analizimin dhe vlerësimin e shpjegimeve dhe provave përfundimtare të depozituara nga subjekti i rivlerësimit me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, të kryer nga Komisioni në këtë vendim, në veçanti në pikën ku trajtohet “Analiza financiare për periudhën 2002 – 2016”.

⁶⁴ Dy prej fëmijëve në moshë të mitur janë përfaqësuar nga subjekti i rivlerësimit, i pajisur me autorizim, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me nr. ***, datë 20.11.2008, për tjetërsimin e pasurisë së fëmijëve të mitur.

⁶⁵ Dokumenti “kontratë shitblerjeje pasuri e paluajtshme” me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.6.2013, redaktuar nga noteri publik, z. A. E.

I pyetur më parë nga ILDKPKI-ja⁶⁶ në lidhje me këtë çështje, subjekti ka deklaruar se: “...nga shitja e kësaj shtëpie pjesa takuese e vlerës së shitjes është ajo e deklaruar prej tij, pasi nëna është në përbërjen familjare të tijën dhe motra, pavarësisht se është në certifikatën e pronësisë, është e martuar...”.

Nga hetimi i kryer⁶⁷, konfirmohet se e motra e subjektit, znj. M.T (D), ka lidhur martesë në datën 18.4.1996, duke mos qenë më pjesë në të njëjtën certifikatë familjare me subjektin e rivlerësimit, ndërsa nëna e subjektit vijon të jetë në të njëjtën certifikatë familjare me subjektin e rivlerësimit.

I pyetur nga Komisioni⁶⁸ mbi deklaratimet e bëra për përfitimin e plotë të vlerës së shitjes të apartamentit në Kukës, duke i kërkuar të sqarojë dhe provojë heqjen dorë nga bashkëpronarët e tjerë nga përfitimi i vlerave përkatëse nga shitja e kësaj pasurie sipas pjesës që zotëronin, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: “...për sa i përket shitjes së apartamentit në Kukës, ai, përveç pjesës së tij, ka disponuar edhe pjesën e fëmijëve E.T, E.T dhe B.T dhe se këtë veprim e ka bërë si kujdestar ligjor i tyre, në përputhje me nenin 343 e vijues të Kodit Civil dhe nenet 231-234 të Kodit të Familjes të kohës. Ky disponim nga ana e tij, bërë edhe për fëmijët e mitur, është në përputhje me interesin dhe vullnetin e tyre, vullnet ky që konfirmohet edhe sot aktualisht nga fëmijët që janë bërë madhorë”.

Në vijim, subjekti ka depozituar⁶⁹ deklaratën noteriale⁷⁰ të datës 3.12.2022, të shtetases M. D (motra e subjektit), në referim të së cilës, ndër të tjera, ajo ka deklaruar se nuk ka përfituar të ardhura nga shitja e apartamentit në Kukës, pasi ka qenë e martuar dhe kjo shtëpi i ka mbetur të vëllait të saj. Gjithashtu ka deklaruar se apartamenti ka qenë i blerë me kredi të butë dhe të gjitha këstet e kredisë i ka shlyer vëllai i saj dhe se ajo për këtë qëllim nuk ka marrë asnjë të ardhur nga shitja, pasi apartamenti është shlyer nga vëllai.

Sa më sipër, bazuar në vetëdeklarimet dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti, si dhe në dokumentacionin e administruar në dosje lidhur me blerjen dhe shitjen e kësaj pasurie, duket se subjekti ka disponuar të ardhura nga shitja e kësaj pasurie, të cilat mund t'i ketë përdorur si burim për blerjen e apartamentit në Tiranë, vetëm ato që i përgjigjen pjesës takuese të pjesëtarëve të cilët ishin/janë në të njëjtin trung familjar me të (persona të cilët duket se kanë banuar/banojnë me të në pasurisë objekt vlerësimi, apartamentin e blerë në Tiranë).

Si rrjedhim, në kushtet kur nuk ka deklaratë të kohës për heqjen dorë nga pjesa takuese e bashkëpronarit tjetër, motrës së subjektit, Komisioni paraprakisht vlerësoi se shuma prej 759,258 lekësh, që përbën 14.3% të vlerës totale të përfituar nga shitja e kësaj pasurie, të mos përfshihej në analizën financiare paraprake si e ardhur e përfituar nga subjekti.

Komisioni vëren se me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit subjekti i ka qëndruar shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ duke ritheksuar se, motra e tij nuk ka përfituar asnjë të ardhur nga shitja e apartamentit në Kukës, rrethanë të cilën referon se ajo vetë e ka konfirmuar nëpërmjet një deklaratë noteriale, kjo përpos faktit se ajo është shkëputur nga familja e origjinës që në vitin 1996, kur ka lidhur martesë, por edhe për shkak se ka qenë vetëm ai i cili ka kryer pagesat për likuidimin e çmimit të blerjes së apartamentit në Kukës.

Në vlerësim përfundimtar të kësaj shtate, trupi gjykues i gjen bindëse deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit mbi përfitimin prej tij të shumës së plotë nga shitja e apartamentit në Kukës, kjo për shkak se rezultoi se provuar se në momentin e nënshkrimit të kontratës paraprake

⁶⁶ Procesverbali i mbajtur pranë ILDKPKI-së në datën 31.5.2016, dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 27.7.2022, të ILDKPKI, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 28.7.2022.

⁶⁷ Referohuni informacionit dhe dokumentacionit të dërguar nga DPGJC-ja me shkresën nr. *** prot., datë 22.7.2022, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 25.7.2022.

⁶⁸ Pyetësori nr. ***, pyetja nr. ***.

⁶⁹ Dokumentacioni i depozituar në Komision në datën 9.12.2022, protokolluar me nr. *** prot.

⁷⁰ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.12.2022, redaktuar nga noteri publik, z. L. D.

për blerjen e apartamentit në dhjetor të vitit 2002, me Drejtorinë Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave Kukës, motra e tij nuk ishte pjesë përbërëse e familjes Tota, e cila kishte marrë më parë statusin e të pastrehut, por edhe në konsideratë të fakteve se: (i) dy pagesat e evidentuara si të kryera nëpërmjet sistemit bankar rezultojnë të jenë bërë nga vetë subjekti; (ii) në deklaratat e interesave privatë periodikë/vjetorë të depozituara ndër vite në ILDKPKI, rezultojnë se subjekti ka deklaruar shlyerjen e kredisë së marrë nga EKB-ja, që lidhet me blerjen e kësaj pasurie, duke mos referuar burime të tjera përveçse të ardhurave të tij dhe personave të lidhur⁷¹.

b. Të ardhurat dhe kursimet ndër vite

Siç u evidentua edhe më sipër, në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, por edhe DIPP-në e vitit 2016 (deklaratë e dorëzuar pas deklaratës *Vetting*), subjekti ka deklaruar se si burim për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi kanë shërbyer të ardhurat dhe kursimet e tij ndër vite, duke përfshirë edhe të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në Kukës.

Bazuar në vetëdeklarimet e bëra, duket se deri në fund të vitit 2012, subjekti i rivlerësimit dispononte gjendjen e likuiditeteve *cash* në shumat 2,000,000 lekë dhe 7,800 euro. Në DIPP-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar shtesën e likuiditeteve *cash* në shumën 4,400,000 lekë, me burim të ardhurat nga shitja e apartamentit në Kukës. Në DIPP-në e vitit 2014 ka deklaruar pakësimin e likuiditeteve *cash* në vlerën 2,000 euro. Në DIPP-në e vitit 2015 ka deklaruar shtesën e likuiditeteve *cash* në shumën 250,000 lekë.

Sa më sipër, bazuar në vetëdeklarimet e bëra, duket se në fund të vitit 2015, subjekti dispononte gjendjen e likuiditeteve *cash* në shumat 6,650,000 lekë dhe 5,800 euro, vlera monetare të cilat rezultojnë se janë të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht pagesën e kryer në datën 16.3.2016 për likuidimin e çmimit të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi.

Por, nga ana tjetër, referuar analizës financiare paraprake të kryer nga Komisioni, duket se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të evidentuara për vitet 2004, 2005, 2006, 2007, 2009 dhe 2011, ku përfshihet edhe krijimi i likuiditeteve gjendje *cash*.

Parë në këtë këndvështrim, për kryerjen e një analize sa më kritike, me qëllim evidentimin e çdo rezultati të mundshëm që i afrohet të vërtetës, Komisioni do të vlerësojë se rezultatet negative të evidentuara në vite reflektojnë drejtpërdrejt në mundësinë e shtesës së likuiditeteve *cash* të deklaruara për çdo vit, si e vetmja pasuri e cila nuk provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se ka qenë e disponuar nga subjekti i rivlerësimit në fund të çdo viti, pasi nuk është pasuri e materializuar/regjistruar në llogari bankare apo në regjistra publikë dhe as e evidentuar/verifikuar/kontrolluar fizikisht nga autoritetet publike.

Pas shqyrtimit dhe analizimit të shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit me dërgimin e prapësimeve⁷² mbi rezultatet e analizës financiare paraprake, në vlerësim të tyre, Komisioni reflektoi ndryshimet përkatëse, nga ku rezultoi se referuar analizës financiare përfundimtare për vitet 2004, 2005, 2006, 2007 dhe 2009 paraqiten me balancë negative fondesh, për një total prej 1,577,274 lekësh⁷³.

⁷¹ Vlen të evidentohet këtu se edhe në rastin e mosmarrjes në konsideratë të deklarimeve të subjektit, por duke vlerësuar se e motra e tij ka përfutur të ardhura nga shitja e kësaj pasurie në përpjesëtim me pjesën takuese të saj, sipas regjistrimit të bërë në zyrën hipotekore, gjithsesi rezultati i analizës financiare për vitin 2013 paraqitet me balancë pozitive fondesh.

⁷² Prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 20.2.2023 (prapësime të dërguara edhe në rrugë elektronike me *email*-in e datës 20.2.2023), si dhe prapësimet dhe provat shtesë të depozituara nga subjekti, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 6.3.2023 (prapësime të dërguara edhe në rrugë elektronike me *email*-in e datës 6.3.2023).

⁷³ Referohuni tabelës përmbledhëse të analizës financiare, aneks nr. ***, pjesë e këtij vendimi, rezultatet e së cilës janë reflektuar në përputhje me analizimin dhe vlerësimin e shpjegimeve dhe provave përfundimtare të depozituara

Në vijim të këtij arsytimi logjik, nga krahasimi i deklarimeve të bëra mbi shtesën e likuiditeteve *cash* ndër vite me rezultatin e analizës financiare për çdo vit përkatës, rezulton se:

- i. për vitin 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shtesë likuiditetesh *cash* në shumën 150,000 lekë, ndërkohë që balanca negative e fondeve paraqitet në shumën 69,719 lekë;
- ii. për vitin 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shtesë likuiditetesh në shumën 500,000 lekë, ndërkohë që balanca negative e fondeve paraqitet në shumën 527,339 lekë;
- iii. për vitin 2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shtesë likuiditetesh *cash* në shumën 500,000 lekë, ndërkohë që balanca negative e fondeve paraqitet në shumën 534,540 lekë;
- iv. për vitin 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shtesë likuiditetesh *cash* në shumën 400,000 lekë, ndërkohë që balanca negative e fondeve paraqitet në shumën 250,951 lekë;
- v. për vitin 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shtesë likuiditetesh *cash* në shumën 4,800 euro (konvertuar në lekë me kursin e datës 31.12.2009, të Bankës së Shqipërisë, në shumën 658,416 lekë), ndërkohë që balanca negative e fondeve paraqitet në shumën 194,725 lekë.

26.58 Nën dritën e rezultateve përfundimtare të analizës financiare, si dhe në një qasje garantiste, Komisioni vlerëson se pavarësisht se për vitet 2004, 2007 dhe 2009 balanca vjetore paraqitet në vlerë negative, subjekti, në rastin më të mirë, ka pasur mundësi të shtonte si likuiditete *cash* diferencën mes vlerës së vetëdeklaruar si shtesë likuiditetesh *cash* dhe vlerës totale të balancës negative vjetore. Kështu, duket se: (i) për vitin 2004 ka pasur mundësi të shtonte likuiditet *cash* në shumën prej rreth 80,000 lekësh; (ii) për vitin 2007, shumën prej rreth 150,000 lekësh; dhe (iii) për vitin 2009, shumën prej rreth 460,000 lekësh. Për vitet 2005 dhe 2006, Komisioni vlerëson se nuk ka pasur mundësi të krijonte shtesat e likuiditeteve *cash*. Sillet në vëmendje këtu se gjithsesi, në prapësimet e dërguara, subjekti ka pretenduar se për këto vite nuk ka deklaruar shtesë likuiditetesh, por ka pasqyruar gjendjen totale të likuiditeteve. Ndërsa vitet e tjera – në të cilat evidentohet se ka deklaruar shtesë likuiditetesh *cash* – rezultati financiar vjetor është pozitiv, çka do të thotë që subjekti ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme, të cilat kanë mundësuar plotësisht krijimin e këtyre shtesave të pasurisë së llojit “likuiditete në gjendje *cash*”. Gjithashtu, rezulton se në vitin 2014 subjekti ka deklaruar pakësim të likuiditeteve *cash* në shumën 2,000 euro (konvertuar në lekë në vlerën prej rreth 280,000 lekësh).

26.59 Parë në këtë optikë, në vijim të kësaj analize, trupi gjykues arrin në përfundimin se në fund të vitit 2015 subjekti i rivlerësimit duket se ka pasur mundësi financiare të dispononte gjendjen e likuiditeteve *cash*, në total në shumën prej rreth 5,880,000 lekësh.

26.60 Bazuar në vetëdeklarimet e bëra nga subjekti ndër vite në ILDKPKI, shpjegimet e dhëna prej tij gjatë hetimit administrativ, me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit dhe gjatë seancave dëgjimore, në vlerësim të provave shkresore të administruara në këtë kuadër, si dhe në përputhje me arsytimin logjik të bërë mbi mundësinë e disponimit të gjendjes së likuiditeteve *cash* në fund të vitit 2015, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë me qëllim evidentimin e aftësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur për kryerjen në datën 16.3.2016 të pagesës në shumën 50,000 USD, për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi – apartamentin e ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

nga subjekti i rivlerësimit me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, të kryer nga Komisioni në këtë vendim, në veçanti në pikën ku trajtohet “Analiza financiare për periudhën 2002 – 2016”.

Tabela nr. 1

Analiza financiare për blerjen e apartamentit në Tiranë, në datën 16.3.2016	Vlerat në lekë
A) Pasuri	-352 200
Apartamenti i ndodhur në rrugën “****”, Tiranë	6 226 000
Ndryshim likuiditeti	-5,720,079
B) Detyrime	0
C) Pasuri neto	-505 922
D) Të ardhura	457 732
Të ardhura nga paga, subjekti i rivlerësimit	337 456
Të ardhura nga paga, bashkëshortja E. T	78 562
Të ardhura nga pensioni familjar për fëmijët	23 784
Të ardhura nga pensioni i nënës së subjektit	17 930
E) Shpenzime	293 865
Shpenzime minimale jetese	293 865
Balanca e fondeve (D-C-E)	- 342 054

26.61 Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare për pagimin në datën 16.3.2016, të vlerës së plotë të çmimit të blerjes së apartamentit në rrugën “****”, në Tiranë, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, por në përputhje edhe me jurisprudencën e Kolegjit⁷⁴, trupi gjykues konkludoi se kjo balancë negative fondesh nuk është e tillë për t’u konsideruar si deklaram i pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

26.62 Në vijim të arsytimit, trupi gjykues vlerëson se balanca negative e rezultuar nga analiza financiare është relativisht e vogël në raport me investimin e kryer, duke pasur parasysh se vetë natyra e analizës financiare është e përafërt dhe jo absolute, e cila mund të paraqesë një shkallë të caktuar pasaktësie në elementet që vlerëson. Në këtë kontekst, duke qenë një balancë relativisht e vogël, si e tillë, nuk arrin nivelin e cenimit të besimit të publikut dhe as nuk ngre dyshime të qenësishme mbi mundësitë financiare të subjektit dhe personave të lidhur për likuidimin e çmimit të plotë të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi. Për këto arsye, trupi gjykues çmon se kjo rrethanë e konstatuar nuk ndikon në vlerësimin tërësor të çështjes.

27. Në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, në seksionin e deklaramit të pasurive, ka deklaruar **aksione në vlerën 1%** (depozituar në vlerën 12,500 euro), të vlerës së përgjithshme të aksioneve të shoqërisë “****” sh.a., dega Kosovë, të vëna në datën 15.12.2005 nga bashkëshortja e subjektit, e ndjera F.T, të përfituara prej tij si trashëgimtar. Gjithashtu, në seksionin e deklaramit të të ardhurave të kësaj deklarate, subjekti ka deklaruar të ardhurat në vlerën *neto* prej 40,000 euro, të përfituara me trashëgim nga shitja e aksioneve në masën 1%, të cilat disponoheshin nga bashkëshortja e tij e ndjerë F.T. Lidhur me këto të ardhura ka deklaruar se ia ka lënë në huapërdorje shtetasit T.H, me interes 1.5% në vit.

27.1 Deklarimet e bëra ndër vite lidhur me këtë pasuri

✓ *Komisioni konstaton se në DIPP-të e viteve 2005 dhe 2006, nuk janë deklaruar aksione apo investime të tjera të kësaj natyre të kryera nga personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, e ndjera F.T.*

27.2 Ndërsa, në DIPP-në e vitit 2007, subjekti ka deklaruar aksione në shoqërinë “****”, depozituar nga bashkëshortja në dhjetor të vitit 2005, shuma prej 12,500 euro, vënë në dijeni në vitin 2007 nga kompania pas vdekjes së bashkëshortes. Gjithashtu ka deklaruar se një pjesë

⁷⁴ Referohuni qëndrimit të mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelit në vendimin nr. 38/2021 (JR).

e vlerës është marrë nga bashkëshortja prej motrës saj. Në vijim ka deklaruar depozitë në Bankën Popullore, shumën prej 44,463 euro, në emër të shtetases F.T (bashkëshortja e ndjerë), vlerë e krijuar nga shitja e aksioneve të “****”, për të cilën deklaroi se *do të tërhiqen kur të çelet dëshmia e trashëgimisë. Pjesa takuese: 25%*.

27.3 Në seksionin e të ardhurave të DIPP-së së vitit 2007, subjekti ka deklaruar *të ardhura nga shitja e aksioneve të shoqërisë “****”, në emër të bashkëshortes, shuma 44,463 euro*. Ndërsa në seksionin e detyrimeve të kësaj deklarate ka deklaruar detyrimin e mbetur ndaj motrës së tij nga huamarrja e marrë prej bashkëshortes F.T që në vitin 2005, në shumën 1,000,000 lekë, e cila, pas vdekjes së saj, e motra i fali 400,000 lekë dhe prej tij është shlyer vlera 200,000 lekë në vitin 2006. Pjesa e mbetur në shumën 400,000 lekë vazhdon të mbetet detyrim pa interes dhe pa afat. Pra, detyrimi i mbetur është në shumën 400,000 lekë.

27.4 Duket se një pjesë e deklarimeve të bëra lidhur me vlerën e aksioneve, burimin e krijimit dhe të ardhurat e përfituara nga shitja e tyre janë bërë me shtesë deklarimi të DIPP-së së vitit 2007, në datën 20.11.2008.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

27.5 Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e hetimit Komisioni konstaton se pasi është pyetur nga ILDKPKI-ja në datën 20.11.2008⁷⁵, në lidhje me mosdeklarimin në kohë të aksioneve në shoqërinë “****”, subjekti ka deklaruar se *në dhjetor të vitit 2005, bashkëshortja e tij F.T ka investuar si punonjëse e “****” sh.a., në degën Kosovë, shumën prej 12,500 euro, sipas vërtetimit të lëshuar nga “****” sh.a., datë 20.11.2008, pa dijeninë e tij. Pas vdekjes së bashkëshortes në vitin 2006 është vënë në dijeni nga “****” sh.a. se bashkëshortja e tij F.T ka pasur aksione në shumën 12,500 euro. Si burim krijimi e kësaj shume sqaron se bashkëshortja e tij, që në vitin 2005, ka marrë, por pa dijeninë e tij, një huamarrje në shumën 1,400,000 lekë dhe, konkretisht, motrës së saj R.S në shumën 400,000 lekë dhe motrës së tij M.D shumën 1,000,000 lekë. Në vijim të deklarimit, subjekti ka shpjeguar se ka shlyer në total detyrimin ndaj kumatës R. S në shumën 400,000 lekë që në vitin 2006, ndërsa detyrimi ndaj motrës në shumën 1,000,000 lekë ka zbritur, pasi ajo i ka falur një pjesë të detyrimit në shumën 400,000 lekë dhe ka shlyer shumën 200,000 lekë, ndërsa vazhdon detyrimi i mbetur ndaj motrës në shumën 400,000 lekë.*

27.6 Në mbështetje të sqarimeve të dhëna, subjekti ka paraqitur në ILDKPKI vërtetimin e datës 20.11.2008, të shoqërisë “****” sh.a., në referim të të cilit konfirmohet se: *Znj. F.T ka investuar si punonjëse e shoqërisë “****” sh.a., në degën Kosovë, shumën 12,500 euro. Pas shitjes së një pjese të aksioneve të shoqërisë “****” sh.a., kompanisë “****”, në vitin 2007 dhe mbylljes së investimit në Kosovë, z. N.T ka përfituar kthim nga ky investim në shumën 44,463 euro. Për këto të ardhura i janë mbajtur detyrimet ndaj shtetit.*

27.7 Pasi u ftua për t’u dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit, i pyetur mbi punësimin e shtetases F.T (bashkëshortja e ndjerë e subjektit) në shoqërinë “****” sh.a., shtetasi T.H, në datën 9.1.2023, ndër të tjera, para Komisionit deklaroi se: *“...subjekti kishte një shok drejtor tek ‘****’, që e mori në punë atë”*.

27.8 Për sa më sipër, në kushtet kur: (i) një nga huadhënëset e deklaruara është motra e subjektit; (ii) vetë subjekti ka deklaruar se ka shlyer një pjesë të huave të marra nga bashkëshortja e ndjerë e tij që në vitin 2006; (iii) shtetasi T.H (bashkëshorti i motrës), të cilit subjekti i kishte marrë në përdorim shtëpinë, ka qenë i punësuar në të njëjtën shoqëri dhe ka kryer të njëjtin investim në të njëjtën periudhë; si dhe (iv) duket se subjekti kishte njohje me një nga drejtorët e shoqërisë – Komisioni ngre dyshime të arsyeshme mbi deklarimin e bërë nga subjekti për padijeninë e tij në momentin e investimit të kryer nga bashkëshortja e ndjerë F.T, në dhjetor të vitit 2005.

⁷⁵ “Procesverbali mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive”, i datës 20.11.2008, përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 27.7.2022, e ILDKPKI-së, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 28.7.2022.

27.9 Si rrjedhojë, duket se subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-të e viteve 2005, 2006 dhe 2007 investimin e kryer nga personi i lidhur në shoqërinë “****” sh.a., si dhe burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për kryerjen e këtij investimi.

27.10 Me dërgimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet/shpjegimet dhe provat e tij në lidhje me konstatimet e mësipërme.

Qëndrimi i mbajtur nga subjekti i rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

27.11 Komisioni vëren se nëpërmjet prapësimeve të depozituara, si dhe deklarimeve të bëra në seancat dëgjimore, subjekti i ka qëndruar shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ, duke ritheksuar se ai nuk ka pasur dijeni në momentin e kryerjes së investimit nga bashkëshortja e tij e ndjerë F.T, të shumës 12,500 euro, në dhjetor të vitit 2005, por se është njoftuar nga punonjës të shoqërisë “****”, pasi bashkëshortja e tij kishte ndërruar jetë. Në këtë kontekst, për shkak se investuesja e kësaj shume ka ndërruar jetë në qershor të vitit 2006, subjekti argumenton se nuk ka mundësi tjetër për të provuar faktin e padijenisë së tij në momentin e investimit, përveçse me thëniet e tij.

27.12 Në vijim të prapësimeve, subjekti ka sqaruar se pavarësisht se deklarimet e tij të para mbi këtë investim janë bërë në DIPP-në e vitit 2007 (me deklarimet shitesë të bëra gjatë vitit 2008), ai kishte marrë dijeni më përpara për këtë investim dhe ende më herët për huat e marra nga ish-bashkëshortja në fund të vitit 2005. Kështu, subjekti referon se në vitin 2006, pas vdekjes së bashkëshortes, mori dijeni për dy huat dhe ka deklaruar shlyerjen pjesore të tyre. Më tej, në vitin 2007, ka marrë dijeni për investimin e kryer nga bashkëshortja dhe shumën që do të kthehej nga ky investim, pasi është njoftuar nga punonjësit e shoqërisë “****” sh.a. Subjekti ka argumentuar se deklarimi i këtij investimi në ILDKPKI është bërë prej tij në momentin që kishte një konfirmim zyrtar nga shoqëria “****” sh.a mbi shumën e investuar, si dhe mbi shumën e përfituar (konkretisht referon shkresën e shoqërisë “****” sh.a., të datës 20.11.2008).

27.13 Edhe sa i takon burimit të shumës së investuar, nisur nga vlera e saj dhe faktit që ai dispononte likuiditete *cash* para investimit, sipas subjektit janë të dhëna që tregojnë qartë që ai nuk ka pasur dijeni për këtë investim. Subjekti deklaroi se me sa ka marrë vesh më vonë, pothuajse të gjithë punonjësit e shoqërisë kanë investuar këtë vlerë edhe më shumë se kjo, pasi drejtuesit u kanë thënë që investimi ka qenë i sigurt që do kthehej, madje dhe me fitime të mira. Në vijim, bën me dije se në atë kohë ka qenë me detyrë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Mat dhe ka qenë i fokusuar në kryerjen e detyrës funksionale si prokuror. Gjithashtu, subjekti deklaroi se, sipas tij, mendon se ajo (i referohet bashkëshortes së ndjerë) ka ditur qëndrimin e tij që ishte kundër marrjes së huave, pasi ishin pa banesë në Tiranë dhe nuk mund të merrnin hua për investime të tjera.

27.14 Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se marrëdhënia e ish-bashkëshortes së ndjerë me motrën e tij ka qenë shumë e mirë, pasi përveç faktit që e kishte kumatë, ato kanë pasur edhe lidhje të mëparshme shoqërore, duke sqaruar se kanë qenë bashkë në shkollë⁷⁶ dhe se ka qenë pikërisht e motra e cila ia ka prezantuar atë. Sipas subjektit, për shkak të këtyre rrethanave dhe me sa duket për shkak të komunikimit të vazhdueshëm dhe dijenisë se motra e tij kishte situatë të shëndoshë financiare, pasi kishte edhe aktivitet privat “bar - kafe”, ish-bashkëshortja e tij (shoqja e motrës së tij) i ka kërkuar këtë vlerë monetare pa i thënë vetë atij, në momentin e marrjes/dhënies së kësaj shume.

Qëndrimi përfundimtar i Komisionit

27.15 Pasi vlerësoi dhe analizoi dokumentacionin e administruar në dosje në raport me deklarimet e bëra nga subjekti në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, shpjegimet dhe

⁷⁶ Rezulton e provuar se znj. F.T, bashkëshortja e ndjerë e subjektit, ka lindur në datën 10.7.1970, ndërsa motra e subjektit, znj. M.D (T), ka lindur në datën 1.12.1969.

provat e depozituara gjatë hetimit administrativ dhe me prapësimet pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe pasi e dëgjoi në seancë dëgjimore, trupi gjykues e gjen bindës pretendimin e subjektit mbi padijeninë e tij në momentin e kryerjes së investimit nga bashkëshortja, e ndjera F.T, në dhjetor të vitit 2005.

27.16 Kështu, në shqyrtim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti, kuadrit ligjor që lidhet me procesin e rivlerësimit kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë, si dhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit⁷⁷, Komisioni çmon se sa i përket vlerësimit të pasurisë, procesi nis me verifikimin dhe kontrollin e deklaramëve të bëra nga subjekti në deklaratën e rivlerësimit *Vetting* e, më tej, me krahasimin dhe analizimin e saj në raport me deklaramet periodike të interesave, kjo në këndvështrim edhe të vlerës së provës që marrin këto deklarata, në kuptim të pikës 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016. Në këtë kuadër, trupi gjykues vlerëson se fillesa e kontrollit nga deklarata e pasurisë së rivlerësimit merr rëndësi në përcaktimin e përgjegjësisë së subjektit të rivlerësimit në kontekst dhe për qëllim të këtij procesi.

27.17 Gjithsesi, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit e ka vetëdeklaruar këtë investim në DIPP-në e vitit 2007, burimin e krijimit të shumës së investuar, në dukje pas marrjes dijeni nga personat e tjerë të lidhur dhe/apo punonjësit e shoqërisë “***” sh.a., si dhe vlerën e investimit të përfituar. Ndalur në këtë pikë, trupi gjykues vlerëson se duket bindës shpjegimi i dhënë nga subjekti i rivlerësimit se ka deklaruar mbi rrethanat e këtij investimi vetëm pasi kishte marrë një konfirmim zyrtar dhe të plotë nga shoqëria “***” sh.a. për këtë marrëdhënie.

27.18 Si konkluzion, në lidhje me këtë çështje, bazuar edhe në qëndrimin e konsoliduar të mbajtur nga Kolegji⁷⁸, trupi gjykues çmon se pasaktësitë në deklaramet periodike, për sa kohë nuk shoqërohen me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi. Aq më tepër që në këtë rast ka të bëjë me një situatë të veçantë ku personi i lidhur, i cili mbartte detyrimin për deklarim, nuk jeton më.

27.19 Në këtë kuadër, Komisioni u fokusua në verifikimin e: (i) mënyrës së kryerjes së këtij investimi; (ii) të ardhurave të deklaruara si burim për kryerjen e tij; si dhe (iii) mënyrës dhe formës së përfitimit të shumës së kthyer nga ky investim.

27.20 Në vijim të verifikimit të deklaratave të interesave privatë/periodikë vjetorë të depozituara ndër vite në ILDKPKI, Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2008 subjekti ka deklaruar se është tërhequr nga Banka Popullore shuma prej rreth 40,000 euro, pas mbajtjes së tatimit prej 10% mbi shumën totale prej 44,463 euro. Këtë shumë deklaroi se e ka dhënë hua me interes, duke deklaruar edhe të ardhura nga interesat e përfituara nga huadhënia.

27.21 Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2008, subjekti nuk ka deklaruar identitetin e personit, të cilit i është dhënë prej tij në formë huaje me interes shuma 40,000 euro, as në seksionin e deklaramit të huas dhe as në seksionin e të dhënave konfidenciale.

27.22 Gjithashtu rezulton se subjekti nuk ka deklaruar ndryshime sa i përket shumës së detyrimit të dhënë hua (shumës fillestare prej 40,000 euro), pra nuk ka deklaruar shlyerje të saj nga viti 2008 deri në momentin e dorëzimit të deklaramës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*.

27.23 I pyetur sërish nga ILDKPKI-ja⁷⁹ (datë 31.5.2016) lidhur me këto aksione dhe vlerën e pretenduar si të përfituar nga shitja e tyre, krahas shpjegimeve të dhëna mbi faktin e

⁷⁷ Shihni vendimin nr. 33, datë 3.11.2021 (JR), të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (faqet 13 - 14).

⁷⁸ Shihni vendimet e Kolegjit: nr. 24/2021 (JR), datë 28.7.2021; nr. 28/2020 (JR), datë 23.10.2020; nr. 25/2021 (JR), datë 29.7.2021.

⁷⁹ Procesverbali mbi shpjegimet e subjektit të deklaramit të pasurive, i datës 31.5.2016, përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 27.7.2022, të ILDKPKI-së, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 28.7.2022.

mosdeklarimit të tyre në vitin 2005, subjekti ka depozituar vërtetimin nr. *** prot., datë 9.6.2016, të shoqërisë “****” sh.a., në referim të të cilit konfirmohet se znj. F.T ka qenë zotëruese e 1% të aksioneve të shoqërisë së sigurimeve “****” sh.a., dega Kosovë, prej datës 15.12.2005. Me miratimin e shitjes së aksioneve nga aksionerët, nga shitja e këtyre aksioneve është përfituar shuma neto prej 40,000 euro, pas mbajtjes së tatimit prej 10%. Meqenëse znj. F.T ishte ndarë nga jeta më 20.6.2006, kjo shumë ka kaluar në llogarinë bankare të z. T.H, punonjës i shoqërisë “****” sh.a. dhe njëkohësisht familjar i saj. Kalimi i kësaj shume është bërë në bankën “****” në datën 20.9.2007.

27.24 Gjithashtu, me shpjegimet e dhëna në datën 31.5.2016, në ILDKPKI, subjekti ka konfirmuar se shuma e përfituar si rezultat i shitjes së aksioneve, të cilat i zotëronte më parë bashkëshortja e tij, i është dhënë hua shtetasit T.H, i cili është bashkëshorti i motrës së tij. Kjo shumë i është dhënë *cash* dhe ende nuk është kthyer, por se ai nuk e di qëllimin e marrjes së saj.

27.25 Me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, me qëllim provueshmërinë e investimit të kryer në vitin 2005 nga bashkëshortja e tij e ndjerë F.T dhe të ardhurat e përfituara prej tij si rezultat i këtij investimi, subjekti i rivlerësimit ka depozituar vërtetimin nr. *** prot., datë 9.1.2017, të shoqërisë “****” sh.a., në referim të të cilit, ndër të tjera, konfirmohet se znj. F.T ka qenë zotëruese e 1% të aksioneve të shoqërisë së sigurimeve “****” sh.a., dega Kosovë, prej datës 15.12.2005. Me miratimin e shitjes së aksioneve nga aksionerët, nga shitja e këtyre aksioneve është përfituar shuma neto prej 40,000 euro pas mbajtjes së tatimit prej 10%. Meqenëse znj. F.T ishte ndarë nga jeta më 20.6.2006, kjo shumë ka kaluar në llogarinë bankare të z. T.H, punonjës i shoqërisë “****” sh.a, dhe njëkohësisht familjar i saj. Kalimi i kësaj shume është bërë në bankën “****” në datën 20.9.2007.

27.26 Gjithashtu, subjekti ka depozituar dokumentin “lëvizje llogarie” nga banka “Societe Generale Albania” (sot OTP Bank), nga ku konfirmohet se në datën 28.12.2005, kunati i subjektit të rivlerësimit, z. T.H, ka depozituar *cash* në llogarinë e tij personale shumën 12,500 euro dhe se po në këtë datë e ka transferuar këtë shumë në llogari të shtetasit Q.D, me përshkrimin “kalim fondi”. Në vijim, në datën 20.9.2007, në këtë llogari të shtetasit T.H është kredituar shuma 80,033 euro, me përshkrimin “fondet e investuesve të degës Kosovë”, nga të cilat në datën 4.10.2007 shuma prej 40,000 euro është transferuar nga shtetasi T.H në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., me përshkrimin “likuidim detyrimi T.H”, ndërsa pjesa tjetër në shumën 40,062 euro është tërhequr *cash* nga shtetasi T.H në datën 24.7.2008.

27.27 Subjekti ka depozituar edhe deklaratën noteriale⁸⁰ të datës 23.3.2009, në referim të së cilës ai vetë ka deklaruar se në datën 23.7.2008 i ka dhënë hua shtetasit T.H shumën prej 40,000 euro dhe se kjo shumë do të kthehet në një afat të pacaktuar kundrejt një interesi mujor 1.5%. Në rast të mospagimit të interesit mujor kjo shumë do të kthehet menjëherë. Në këtë deklaratë është pasqyruar me shkrim të lirë dore shënimi “jep pëlqimin T.H”, shoqëruar me nënshkrimin përkatës.

27.28 Pasi Komisioni i kërkoi subjektit⁸¹ që shtetasi i deklaruar prej tij si huamarrës të konfirmojë marrëdhënien me akt shkresor në formën e kërkuar nga ligji, subjekti deklaroi se është dorëzuar në Komision deklarata e bërë para noterit për këtë hua dhe se ajo ka fuqi të plotë ligjore.

27.29 Shtetasi T.H, në datën 9.1.2023, u ftua për t’u dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit, ku në deklaratimet e dhëna para Komisionit, ndër të tjera, konfirmoi marrjen e kësaj huaje nga subjekti i rivlerësimit, duke referuar edhe nënshkrimin e një deklaratë noteriale në kohën e marrjes së saj. Ndërsa, pasi u pyet nga Komisioni mbi shlyerjen e huas së marrë nga subjekti, dëshmitari

⁸⁰ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.3.2009, redaktuar nga noteri publik, znj. M.Sh.

⁸¹ Pyetja nr. *** e pyetësorit nr. ***, të dërguar nga Komisioni.

T.H shfaqet i paqartë, duke deklaruar se ka shlyer pjesërisht këtë hua, pa specifikuar shumat e shlyera dhe periudhat përkatëse.

27.30 Lidhur me këtë rrethanë, në prapësimet e depozituara pas rezultateve të hetimit, subjekti ka deklaruar se shtetasi T.H ka kryer vetëm disa pagesa të interesave që lidhen me këtë hua, sipas deklarimeve të bëra në deklaratat e interesave privatë/periodikë vjetorë të viteve 2008 dhe 2009, duke sqaruar se deklaratimet e këtij shtetasi kanë të bëjnë pikërisht me shlyerjen e këtyre interesave të huas.

27.31 Në vijim të verifikimeve të kryera, referuar informacionit/dokumentacionit të administruar nga OTP Bank (ish-Societe Generale Bank/Banka Popullore)⁸², konfirmohet se në datën 27.12.2005, bashkëshortja e ndjerë e subjektit të rivlerësimit, znj. F.T, ka depozituar *cash* në llogarinë e saj personale shumën 12,500 euro. Në datën 28.12.2005, ajo e ka transferuar këtë shumë në llogari të shtetasit Q.D, me përshkrimin “kalim fondi”. Nuk evidentohen transaksione të tjera në këtë llogari.

27.32 Komisioni konstaton se, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së evidentohet shkresa⁸³ e shoqërisë “***” sh.a., e datës 13.7.2017, në referim të së cilës konfirmohet se znj. F.T ka qenë e punësuar pranë kësaj shoqërie nga data 1.2.2005 deri në datën 13.6.2006, ku përcaktohen edhe të ardhurat e saj nga punësimi. Gjithashtu konfirmohet se kjo e fundit ka qenë zotëruese e 1% të aksione të shoqërisë “***” sh.a., dega Kosovë. Si aksionere e shoqërisë me shitjen e aksioneve të saj në datën 3.7.2007 ka përfituar një vlerë neto prej 40,000 euro pas mbajtjes së tatimit në burim në vlerën 10%. Meqenëse znj. F.T është ndarë nga jeta në datën 20.6.2006, vlera e mësipërme është përfituar nga z. T.H (familjar i të ndjerës dhe njëkohësisht punonjës i shoqërisë “***” sh.a). Pagesa e kësaj shume është bërë në datën 20.9.2007 në bankën “Societe Generale Albania”.

27.33 Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar bashkëlidhur kësaj shkrese, evidentohet procesverbali i datës 3.7.2007, mbi mbledhjen e asamblesë së jashtëzakonshme së aksionarëve të shoqërisë “***” sh.a., nga ku:

i. Në pikën 3 të tij është referuar rregullimi i marrëdhënieve mes aksionarëve në lidhje me investimin në aktivitetin e degës së shoqërisë “***” sh.a., në Kosovë; në pikën 3.a) përcaktohet se të zgjidhë marrëveshjen e investimit mes shoqërisë “***” sh.a. dhe një grupi investitorësh të jashtëm (kryesisht aksionarë dhe punonjës të “***” sh.a.) në aktivitetin e degës së shoqërisë “***” sh.a. në Kosovë, ndërsa në pikën 3.b) përcaktohet se marrëveshja e investimit do të përfundohet nëpërmjet një marrëveshjeje të veçantë të nënshkruar nga të gjithë investitorët dhe përfaqësuesi i shoqërisë “***” sh.a., me anë të së cilës secilit investitor do t’i paguhet proporcionalisht me investimin një kontribut, i cili do të të reflektojë një vlerësim të degës së shoqërisë “***” sh.a. në Kosovë në shumën 5,000,000 euro. Sipas tabelës nr. 2 bëhet ndarja e shumës së përfituar për çdo investitor.

Në numrin 19 rendor të tabelës nr. 2, në kolonën “emri i investitorit” vërehet emri i subjektit të rivlerësimit Naim Tota, me pjesëmarrje 1% dhe me vlerë të përfituar 44,463 euro.

Në numrin 24 rendor të tabelës nr. 2, në kolonën “emri i investitorit” vërehet emri i kunatit të subjektit, z. T.H, me pjesëmarrje 1% dhe me vlerë të përfituar 44,463 euro.

ii. Ndërsa në pikën 5 të procesverbalit përcaktohet se, përcaktimi i tabelës së çmimit të shitjes për çdo aksioner pas zbritjes së komisionit për Drejtorin e Përgjithshëm, vlerës së investimit në Kosovë dhe huave ndaj shoqërisë.

⁸² Shkresë nr. ***prot., datë 13.9.2022, e OTP Bank, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 13.9.2022.

⁸³ Shkresë nr. *** prot., datë 13.7.2017, dërguar nga “***” sh.a., pjesë e dosjes së ILDKPKI-së.

27.34 I pyetur nga Komisioni gjatë hetimit administrativ mbi investime të kryera⁸⁴, subjekti ka deklaruar se *ish-gruaja e tij F.T ka qenë zotëruese e 1% të aksioneve në vlerën 12,500 euro, në shoqërinë e sigurimeve “***” sh.a., dega Kosovë, për të cilën është bërë deklarimi përkatës pranë ILDKPKI-së dhe në deklaratën Vetting. Në vitin 2007 aksionet e kësaj kompanie janë blerë nga një kompani austriake dhe vlera e aksioneve është konvertuar në shumën 40,000 euro (pas mbajtjes së tatimit), pra është përfituar si e ardhur diferenca prej 27,500 euro. Ndërkaq bën me dije se kjo e ardhur, në vijim, i është dhënë hua një të afërmi të tij. Të ardhura të tjera për shkak të zotërimit të këtyre aksioneve për periudhën nuk ka...*

27.35 I pyetur sërish nga Komisioni mbi investimin e kryer nga bashkëshortja e tij F.T, të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga shitja e aksioneve⁸⁵ dhe mbi rrethana të tjera që lidhen me transaksionet e kryera, mënyrën dhe formën e përfitimit të të ardhurave, subjekti i ka qëndruar deklarimeve të mëparshme mbi padijeninë e tij në momentin e investimit, duke shpjeguar se është njoftuar nga shoqëria “***” sh.a. mbi ekzistencën e aksioneve dhe se kalimi i shumës prej rreth 40,000 euro në llogari të shtetasit T.H është kryer nga kjo shoqëri, sipas vërtetimeve që ajo ka lëshuar.

27.36 Subjekti ka depozituar si provë të re deklaratën noteriale⁸⁶ të datës 19.9.2007, në referim të së cilës ka deklaruar se me marrjen e shumës prej 44,463 euro nga shoqëria “***” sh.a. heq dorë pa rezerva dhe në mënyrë të përvokueshme nga çdo e drejtë për të përfituar nga të ardhurat e realizuara nga shoqëria e sigurimeve “***” sh.a. të drejtorit të përgjithshëm, z. Q. D, si dhe degës në Kosovë, duke përfshirë drejtorinë, aksionerët, të punësuarit, pasardhësit e tyre në detyrë dhe personat e tretë, të cilët kanë përfituar të drejta në këtë shoqëri, degët apo filialet e saj të çfarëdolloji qofshin. Gjithashtu, ai ka deklaruar se heq dorë pa rezerva dhe në mënyrë të përvokueshme nga çdo e drejtë dhe pretendim i çfarëdolloj natyre përkundrejt shoqërisë (përfshirë këtu degët apo filialet e saj) pa kufizime dhe kushte, heq dorë pa rezerva nga e drejta për të paraqitur ankime, peticione dhe çdo akt tjetër të ngjashëm kundër shoqërisë, si dhe heq dorë nga e drejta për të filluar çdo proces gjyqësor ose jashtëgjyqësor që ka të bëjë me cilësinë e tij si investitor në degën e shoqërisë në Kosovë apo për arsye të tjera.

27.37 Sa më sipër, duket se nuk provohet se mbi bazën e cilit dokument u kaluan të drejtat që dispononte bashkëshortja e tij e ndjerë F.T, si investitore në shoqërinë “***” sh.a., si dhe nuk është depozituar dokumentacion mbi bazën e të cilit, subjekti i rivlerësimit të ketë autorizuar këtë shoqëri për kalimin e shumës së pretenduar si të përfituar nga shitja e aksioneve në favor të shtetasit T.H.

27.38 Pasi subjektit iu kërkua të paraqesë argumentet/shpjegimet e tij përfundimtare, si dhe të depozitojë prova të reja të mundshme duke sqaruar në mënyrë shteruese këtë marrëdhënie dhe të gjitha veprimet dhe transaksionet e kryera prej tij në funksion të saj, Komisioni vëren se me dërgimin e prapësimeve subjekti i ka qëndruar të gjitha deklarimeve të bëra gjatë hetimit administrativ, duke argumentuar se nga të gjitha aktet e administruara, ku përfshihen shkresat e shoqërisë “***” sh.a., por edhe deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.7.2007, konfirmohet se shuma në fjalë i përket atij si bashkëshort i të ndjerës dhe fëmijëve të tij dhe se kjo shumë i është kaluar në kushtet e mirëbesimit shtetasit T.H, i cili ishte familjar i tij dhe punonjës i shoqërisë “***” sh.a., veprim ky i kryer nga banka, kjo edhe për shkak se ai nuk dispononte llogari të hapur në atë kohë në Bankën Popullore.

27.39 Në këtë kuadër, vlerësohet edhe përpjekja e bërë nga subjekti për disponimin e informacionit shtesë për këtë marrëdhënie nga shoqëria “***” sh.a., e cila, pas kërkesës së bërë nga subjekti, me shkresën⁸⁷ e datës 15.2.2023, ka informuar se nuk disponon dokumente fizike

⁸⁴ Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, pyetja nr. ***.

⁸⁵ Pyetja nr. ***e pyetësorit nr. ***, të dërguar nga Komisioni.

⁸⁶ Deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.9.2007, redaktuar nga noteri publik, znj. M. S.

⁸⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 15.2.2023, e shoqërisë “***” sh.a.

për periudhën në të cilën ka ndodhur kjo veprimtari, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar dhe se po ashtu nuk disponon dokumente fizike për periudhën në të cilën është kryer shitja e aksioneve të degës Kosovë.

27.40 Siç u evidentua edhe më sipër, subjekti ka referuar se si burim kryesor për kryerjen e investimit në vitin 2005 të shoqëria “****” sh.a. kanë shërbyer dy hua të marra nga bashkëshortja e tij, prej motrës së saj dhe motrës së tij.

27.41 Në këtë kontekst, sa i përket burimit të krijimit të shumës së investuar në vitin 2005 nga bashkëshortja e subjektit, znj. F.T, me vlerë 12,500 euro, Komisioni vlerësoi të verifikojë dhe analizojë burimet e vetëdeklaruar nga subjekti. Si rrjedhojë, motra e subjektit, znj. M.D, dhe motra e bashkëshortes së tij të ndjerë, znj. R.M, kategorizohen në cilësinë e personave të tjerë të lidhur, në përputhje me pikën 14 të nenit 3 dhe pikën nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016.

27.42 Në këto rrethana, Komisioni i kërkoi subjektit⁸⁸ që shtetaset e sipërcituara të konfirmojnë marrëdhënien e huas së deklaruar, si dhe të depozitojë dokumentacion justifikues ligjor mbi të ardhurat e tyre, të cilat kanë shërbyer për krijimin e vlerave monetare të pretenduara si të dhëna hua në vitin 2005 në favor të bashkëshortes së subjektit, të ndjerës F.T.

27.43 Komisioni konstaton se subjekti ka depozituar deklaratat noteriale⁸⁹ të këtyre shtetaseve, në referim të të cilave ato pranojnë dhënien hua të këtyre shumave në vitin 2005, si dhe kanë deklaruar mbi burimin e të ardhurave të tyre.

27.44 Në vijim, gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorëve të bërë nga Komisioni, subjekti ka depozituar dokumentacion mbi të ardhurat e përfituara nga punësimi për shtetasit M (M) D (T)⁹⁰, R (R) M dhe S.S (identifikuar si bashkëshorti i R. M)⁹¹.

27.45 Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti, rezulton se të ardhurat totale të dokumentuara për shtetasen M.D (motra e subjektit), për periudhën 1994 – 2005, janë në vlerën 3,520,155 lekë, ndërsa të ardhurat totale të dokumentuara për shtetasen R.M dhe bashkëshortin e saj S.S, për periudhën 1997 – 2005, janë në total në shumën 2,276,357 lekë.

27.46 Bazuar në deklaratimet e bëra dhe në dokumentacionin e administruar në dosje, Komisioni kreu analizën financiare me rezervë, me qëllim verifikimin e mundësisë për dhënien në vitin 2005 nga shtetasja M.D të shumës 1,000,000 lekë dhe nga shtetasja R.M të shumës 400,000 lekë, në favor të bashkëshortes së subjektit, e ndjera F.T, duke përllogaritur vetëm shpenzime minimale jetike sipas përbërjes së tyre familjare për këto vite, nga ku duket se personat e tjerë të lidhur nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime financiare të ligjshme për të mundësuar krijimin e shumave 1,000,000 lekë dhe 400,000 lekë, të deklaruar si të dhëna hua në vitin 2005 në favor të bashkëshortes së subjektit, e ndjera F.T.

27.47 Në funksion të provueshmërisë së burimeve financiare të personave të tjerë të lidhur, të cilat janë vetëdeklaruar se kanë shërbyer për krijimin e shumave të dhëna në vitin 2005 në favor të bashkëshortes së subjektit, të ndjerës F.T, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni kaloi barrën e provës subjektit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

⁸⁸ Pyetësori nr. ***.

⁸⁹ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.11.2022, redaktuar nga noteri publik, znj. M. B; deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.11.2022, redaktuar nga noteri publik, z. L.D; deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.12.2022, redaktuar nga noteri publik, z. L.D.

⁹⁰ Vërtetim për bazën e vlerësueshme lëshuar nga DRSSH-ja Kukës; vërtetim nr. *** prot., datë 9.3.2021, lëshuar nga “****” sh.a.

⁹¹ Vërtetim për bazën e vlerësuar nga ISSH-ja për vitet 1997 – 2000, 2001 – 2004 dhe 2005 – 2008, për shtetasen R(R) M; vërtetim për bazën e vlerësuar nga ISSH-ja për vitet 1998 – 2000, 2002 – 2003 dhe 2004 – 2006, për shtetasin S. S.

Qëndrimi i mbajtur nga subjekti i rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

27.48 Sa i përket të ardhurave të motrës së tij, znj. M.D, subjekti pretendon se ekonomia familjare e saj ka qenë e qëndrueshme dhe me likuiditete të mjaftueshme, të cilat justifikojnë plotësisht shumën prej 1,000,000 lekësh që ia ka dhënë ish-bashkëshortes së tij, të ndjerës F.T, duke deklaruar se në momentin e dhënies së huas motra tij kishte mbi 10 vjet që punonte në *** dhe mbi 12 vjet e punësuar. Subjekti parashtron se të ardhurat nga puna në këtë periudhë, sikurse referohen edhe në raportin e Komisionit, krijojnë shumën prej rreth 3,500,000 lekësh, duke argumentuar se kjo vlerë është më shumë se trefishi i shumës prej 1,000,000 lekësh të dhënë hua nga ana e saj. Gjithashtu, subjekti pretendon se motra e tij, znj. M.D, dhe bashkëshorti i saj kanë pasur dhe kanë një biznes “bar - kafe” që nga viti 1996 e në vazhdim, duke pasur aktivitet të pandërprerë prej 26 vjetësh, ndërsa në momentin e dhënies së huas biznesi në fjalë ushtrohej prej 10 vjetësh.

27.49 Në mbështetje të deklarimeve të tij, subjekti ka depozituar dokumentacionin: (i) deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.2.2023, e shtetasit I. D (bashkëshorti i motrës); (ii) vërtetim nga dokumentet hipotekore nr. ***, datë 27.3.2014; (iii) kartelë e pasurisë së paluajtshme, datë 8.4.2014; (iv) hartë treguese të regjistrimit; dhe (v) fletë e printuar nga sistemi “Web System” i OSHEE-së, me informacion mbi pagesën e energjisë elektrike.

27.50 Megjithëse nuk ka provuar regjistrimin në organin tatimor të aktivitetit “bar - kafe”, të pretenduar si të kryer nga familja e motrës së tij, ka pretenduar se fitimi i mundshëm i realizuar si rezultat i këtij aktiviteti për vitet 2000 – 2005, ka qenë në shumën 2,000,000 lekë, e dhënë kjo e marrë në bazë të argumentimit dhe përllogaritjeve të bëra në aktekspertimin kontabël⁹², datë 17.2.2023, të përgatitur nga znj. J. M, depozituar si provë nga subjekti.

27.51 Në vijim, sa i përket të ardhurave të familjes së motrës së tij, subjekti ka paraqitur⁹³ si dokumentacion shtesë: (i) vërtetimin⁹⁴ e datës 1.3.2023, të lëshuar nga DRSSH-ja Kukës, për bazën e vlerësueshme me anë të të cilit vërtetohet se shtetasi I.D, në bazë të listëprezencave të Komunës B, për periudhën 1994 – 1995, është trajtuar me pagë; (ii) vërtetimin e datës 1.3.2023, “Për të vetëpunësuarit në bujqësi”, lëshuar nga DRSSH-ja Kukës, në referim të të cilit konfirmohet se shtetasi I.D figuron të ketë/ketë pasur tokë bujqësore në pronësi/përdorim dhe se ka qenë i siguar si i vetëpunësuar në bujqësi prej vitit 1996 në regjistrin themeltar të të vetëpunësuarve në bujqësi me nr. ***, duke depozituar kontributet për periudhat 1996 – 2001 dhe 2004 – 2005; (iii) vërtetimin e datës 2.3.2023, lëshuar nga ASHK Drejtoria Vendore Kukës, në të cilin duket se në emër të babait të shtetasit I.D janë të regjistruara 5 pasuri të llojit “arë” me sipërfaqe totale 7,325 m²; (iv) certifikatën familjare për përbërjen e familjes së shtetasit I.D në vitin 1986; (v) certifikatën familjare për përbërjen e familjes së shtetasit I.D në datën 1.8.1991; (vi) shkresën e thjeshtë, me shkrim të lirë, në të cilën duket se shtetasi I.D ka përfituar në datën 15.10.2005 huan me vlerë 1,500,000 lekë nga shtetasi B.Gj, për një afat shlyerjeje prej 3 vitesh; (vii) deklaratën noteriale⁹⁵ datë 6.3.2023, të lëshuar nga shtetasi B.Gj, nëpërmjet së cilës ky i fundit konfirmon dhënien e një huaje në shumën 1,500,000 lekë në vitin 2005 ndaj shtetasit I.D; dhe (viii) vërtetime⁹⁶ njësie me origjinalin për llogaritë vjetore të shoqërisë “****” sh.p.k., me përfaqësues ligjor dhe aksioner të vetëm shtetasin B.Gj, për vitet 2004 dhe 2005.

⁹² Me dërgimin e prapësimeve pas dërgimit të rezultateve të hetimit subjekti i rivlerësimit ka depozituar si provë, aktekspertimin kontabël, datë 17.2.2023, i kryer nga audituesja ligjore, znj. J.M, pajisur me nr. licence ***, në të cilin reflektohen ndryshimet në analizë financiare sipas pretendimeve të ngritura nga subjekti, si dhe në mbështetje të provave shtesë të administruara prej tij.

⁹³ Dokumentacioni i paraqitur nga subjekti me prapësimet e depozituara pas riçeljes së hetimit dhe dërgimit të rezultateve shtesë të hetimit.

⁹⁴ Vërtetim nr. *** prot., datë 1.3.2023, lëshuar nga DRSSH-ja Kukës.

⁹⁵ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.3.2023, nga noteri publik, z. L.D.

⁹⁶ Vërtetim njësie me origjinalin nr. *** rep., datë 6.3.2023 dhe nr. *** rep., datë 6.3.2023, nga noteri publik, z. L. D.

27.52 Në referim të provave të depozituara, ndër të tjera, subjekti pretendon se del qartë fakti se bashkëshorti i motrës së tij ka kryer aktivitet në bujqësi dhe ka realizuar të ardhura të konsiderueshme, por se për shkak të natyrës së tyre nuk deklaroheshin. Në mungesë të kohës së mjaftueshme për të kërkuar dhe realizuar kryerjen e një aktekspertimi mbi të ardhurat e mundshme të përfituara nga bashkëshorti i motrës në bujqësi, subjekti ka kërkuar që, minimalisht, në analizën financiare të personit tjetër të lidhur të reduktohen shpenzimet bazë ushqimore dhe për pije joalkoolike, duke referuar qëndrimin e mbajtur nga Komisioni në vendimin nr. 190, datë 26.7.2019, për subjektin e rivlerësimit R. L., lënë në fuqi nga Kolegji, kjo edhe për shkak se sipas tij shpenzimet në rrethin e Kukësit nuk janë të njëjta si ato në rrethin e Tiranës.

27.53 Sa i përket burimit të të ardhurave të motrës së subjektit, znj. R. S, ka pretenduar se ajo dhe bashkëshorti i saj kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga paga për të përballuar dhënien e huas në shumën 400,000 lekë, por edhe se në dhjetor të vitit 2005, pikërisht në momentin e investimit të kryer, ata kanë marrë nga një kredi në shumën 200,000 lekë/secili, vlerat e të cilave thotë se janë përdorur për dhënien e huas në favor të ish-bashkëshortes së tij, të ndjerës F.T.

27.54 Në vijim të argumenteve të tij, për sa i përket burimit të të ardhurave për dhënien e huas nga motra e ish-bashkëshortes, subjekti parashtron se në rezultatet e hetimit, të dërguara nga Komisioni mbi mundësinë e tyre financiare për dhënien e kësaj shume, vëren se raporti i të ardhurave të dy arsimtarëve dhe shpenzimeve të tyre deri në fund të vitit 2005 del me balancë negative, pra se sipas Komisionit dy arsimtarë në një fshat të Lushnjës, në G, nuk mund të jetonin me të ardhurat e tyre nga puna. Në këtë kontekst, dhe faktit që ata kanë banuar në fshat, pretendon se shpenzimet kanë qenë më të ulëta, si dhe se familja e kumatës ka pasur të ardhura dhe ka mbuluar shpenzimet nga prodhimet bujqësore në fshat.

27.55 Gjithsesi, në vijim të prapësimeve të tij lidhur me këtë çështje, subjekti deklaroi se pas kontakteve që ka bërë me kumatën, ajo i ka pohuar se burimi kryesor për dhënien e huas kanë qenë dy kreditë e marra prej tyre në dhjetor të vitit 2005, kjo pas kërkesës së ish-bashkëshortes së tij. Subjekti pretendon se, megjithëse vërehet që një nga kreditë është marrë një ditë pas depozitimit të shumës nga ish-bashkëshortja e tij, kunata i ka thënë se edhe këtë shumë ia ka dhënë motrës, pasi ajo i kishte thënë që ia kishte marrë një kolegu të saj te puna sa për një ditë, për të kryer investimin. Në përfundim të parashtrimeve të bëra, subjekti argumenton se vetë fakti i marrjes së këtyre dy kredive në momentin e kryerjes së këtij investimi tregon qartë se ato kanë shërbyer pikërisht për kryerjen e këtij investimi. Për më tepër, parashtron se provohet se ai ka shlyer së paku një këst kredie, dokumentuar kjo me provën e depozituar në Komision⁹⁷, fakt i cili tregon njohjen prej tij të kësaj huaje të marrë nga ish-bashkëshortja. Në këto rrethana të reja subjekti pretendon se ka provuar plotësisht burimet financiare të kumatës së tij për dhënien e huas.

Analiza e kryer nga Komisioni/vlerësimi përfundimtar i shpjegimeve dhe provave

27.56 Pas analizimit të prapësimeve të bëra nga subjekti në raport me dokumentacionin ligjor provues të dërguar në mbështetje të tyre, sa i përket burimit të të ardhurave dhe analizës financiare të personave të tjerë të lidhur, krahas të ardhurave të provuara gjatë hetimit administrativ, Komisioni argumenton si vijon:

i. Sa i përket personit tjetër të lidhur, motrës së tij M. D, trupi gjykues vlerëson se mbeten të paprovuara dhe të karakterit deklarativ pretendimet e bëra nga subjekti mbi përfitimin e të ardhurave si rezultat i ushtrimit të aktivitetit “bar - kafe” nga familja e saj. Gjithashtu, trupi gjykues çmoi të mos pranojë të përfshijë në analizë financiare të personit tjetër të lidhur dhe familjes së saj shumën e pretenduar si të marrë hua nga shtetasi B.Gj në tetor të vitit 2005.

⁹⁷ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 2.2.2023, e “Raiffeisen Bank”, vërtetuar njësisht me origjinalin me dokumentin noterial nr. *** rep., datë 18.2.2023.

Nga ana tjetër, bazuar në deklaratimet e bëra dhe në provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni krijoi bindjen se bashkëshorti i motrës së subjektit, për periudha që i përkasin viteve 1996 – 2001 dhe 2004 – 2005, ka ushtruar aktivitetet si i vetëpunësuar në bujqësi, duke paguar edhe kontributet e sigurimeve shoqërore për këtë periudhë. Lidhur me këtë veprimtari, nga e cila nuk janë evidentuar të ardhura, nisur nga fakti i provuar i vetëpunësimit në bujqësi të shtetasit I.D– trupi gjykues vlerësoi që në analizën financiare do të zbriten shpenzimet, të cilat prezumohet se janë mbuluar nga produktet bujqësore, të cilat vlerësohet se janë produkte që shërbejnë për ushqim dhe pije joalkoolike. Duke iu referuar rezultateve të anketës së buxhetit të familjeve në Shqipëri për vitet 2006 – 2007 (informacion i marrë nga faqja e *web-it* të INSTAT-it)⁹⁸, rezultoi se grupi i konsumit, ushqim dhe pijet joalkoolike përbën 47.6% të strukturës së konsumit. Gjithashtu, bazuar në vërtetimin e Komunës B, Komisioni do të reflektojë shtesë në të ardhurat e bashkëshortit të motrës së subjektit, z. I.D.

Bazuar në deklaratimet e bëra dhe në dokumentacionin e administruar në dosje, Komisioni kreu analizën financiare – me rezervë, me qëllim verifikimin e mundësisë për dhënien në vitin 2005 nga shtetasja M.D, të shumës 1,000,000 lekë, në favor të bashkëshortes së subjektit, e ndjera F.T, duke përlloritur vetëm shpenzime minimale jetike sipas përbërjes së tyre familjare për këto vite, të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 2

Të ardhura M. D. (në lekë)	Të ardhura I. D. (në lekë)	Shpenzime jetike (në lekë)	Mundësia e kursimit (në lekë)
3 520 155	112 128	2 326 282,689	1 306 000,311

Sa më sipër, Komisioni konstaton se personi tjetër i lidhur, znj. M.D, ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme, të cilat mundësojnë plotësisht krijimin e shumës prej 1,000,000 lekësh, të dhënë hua në vitin 2005 në favor të bashkëshortes së subjektit, e ndjera F.T.

ii. Sa i përket personit tjetër të lidhur, znj. R.M (S), trupi gjykues i gjen bindëse pretendimet e subjektit mbi përlloriturjen e shpenzimeve jetike të familjes së saj dhe se gjithashtu duken bindëse deklaratimet e bëra prej tij mbi qëllimin e marrjes së dy kredive nga bashkëshortët S në dhjetor të vitit 2005 dhe mbi destinacionin e tyre, konkretisht një kredi e marrë në datën 6.12.2005 dhe tjetra në datën 28.12.2006. Në këtë konkluzion arrihet duke u mbështetur edhe në faktin e referuar në shkresën e “Raiffeisen Bank” lidhur me këto kredi (të depozituar si provë nga subjekti)⁹⁹, në referim të së cilës nga të dhënat lidhur me pagesat e kësteve të kredisë rezulton se në datën 25.7.2006 është kryer derdhja e kështit të kredisë nga ana e shtetasit Naim Tota. Gjithashtu, duket se gjejnë mbështetje deklaratimet e bëra nga subjekti se *ka shlyer në total detyrimin ndaj kumatës R. S në shumën 400,000 lekë që në vitin 2006*, me informacionin e dërguar nga “Raiffeisen Bank”, nga ku rezulton së njëra nga kreditë është mbyllur në datën 27.10.2006 dhe tjetra në datën 30.4.2007.

Si rrjedhim, Komisioni vlerëson se edhe personi tjetër i lidhur, znj. R.S, ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht dhënien e shumës prej 400,000 lekësh, në favor të personit të lidhur, motrës së saj F.T, në dhjetor të vitit 2005.

27.57 Bazuar në vetëdeklaratimet e bëra nga subjekti ndër vite në ILDKPKI, shpjegimet e dhëna prej tij gjatë hetimit administrativ, me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit dhe gjatë seancave dëgjimore, si dhe në vlerësim të provave shkresore të administruara në dosje, Komisioni kreu analizën e treguesve për vitin 2005, të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

⁹⁸ http://www.instat.gov.al/media/2067/buxheti_i_familjes.pdf

⁹⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 2.2.2023, e “Raiffeisen Bank”.

Tabela nr. 3

Analiza financiare për vitin 2005	Vlerat në lekë
A) Pasuri	2 103 286
Aksione pranë shoqërisë “****” sh.a.	1 546 288
Ndryshim likuiditeti	556 998
B) Detyrime	1 400 000
Detyrime ndaj M.D	1 000 000
Detyrime ndaj R. S	400 000
C) Pasuri neto	703 286
D) Të ardhura	889 090
Të ardhura nga paga, subjekti i rivlerësimit	711 250
Të ardhura nga paga, bashkëshortja F. T	146 520
Të ardhura nga pensioni i nënës së subjektit	31 320
E) Shpenzime	713 143
Shpenzime minimale jetese	657 342
Shpenzime për shlyerjen e kredisë ndaj EKB-së Kukës	55 801
Balanca e fondeve (D-C-E)	-527 339

27.58 Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë mungesë të burimeve financiare për të justifikuar plotësisht kryerjen e investimit në shoqërinë “****” sh.a., në datën 27.12.2005, krijimin e pasurive të tjera, si dhe mbulimin e shpenzimeve të evidentuara nga Komisioni gjatë këtij viti.

27.59 Komisioni vëren se sa i përket këtij viti, me anë të prapësimeve të tij, subjekti pretendon se në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë të depozituar në ILDKPKI, ka deklaruar gjendjen e likuiditeteve *cash* dhe jo shtesë të tyre. Në këtë këndvështrim, nëse do të merrej për bazë edhe ky pretendim, balanca negative e fondeve për këtë vit do të shkonte në -27,339 lekë (pasi në analizë është referuar si shtesë shuma 500,000 lekë, e pretenduar si gjendje nga subjekti). Kështu, në vijim të arsyetimit të bërë si më sipër në këtë vendim, nëse do të merret e mirëqenë se rezultati negativ i evidentuar do të ndikojë drejtpërdrejt në mundësinë e shtesës së likuiditeteve *cash* të deklaruara, si e vetmja pasuri e cila nuk provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se ka qenë e disponuar nga subjekti i rivlerësimit në fund të vitit, pasi nuk është pasuri e materializuar/regjistruar në llogari bankare apo regjistra publikë dhe as e evidentuar/verifikuar/kontrolluar fizikisht nga autoritetet publike, rrethanë kjo e vlerësuar në harmoni me faktin se subjekti nuk e pretendon krijimin e kësaj shtese të likuiditeteve *cash*, do të çonte në një rezultat të papërfillshëm negativ financiar, i cili nuk do të vendoste në dyshim mundësinë financiare për kryerjen e investimit nga ish-bashkëshortja e ndjerë e subjektit në dhjetor të vitit 2005.

27.60 Nën dritën e këtij arsyetimi, pra në konsideratë të faktit se vetë natyra e analizës financiare është e përafërt dhe jo absolute, e cila mund të paraqesë një shkallë të caktuar pasaktësie në elementet që vlerëson, trupi gjykues konkludoi se kjo balancë negative fondesh e konstatuar për vitin 2005 nuk është e tillë për t’u konsideruar si deklaram i pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

28. Deklarimi i pasurive nga personi i lidhur, nëna e subjektit, znj. N. T

28.1 Tokë bujqësore në zonën kadastrale nr. ***, Njësia Administrative B, me nr. pasurie ***, me sip. 687 m², në fshatin V të rrethit Kukës.

28.2 Tokë bujqësore në zonën kadastrale nr. ***, Njësia Administrative B, me nr. pasurie ***, me sip. 1437 m², në fshatin V të rrethit Kukës.

28.3 Personi i lidhur ka deklaruar se këto sipërfaqe toke nuk janë shfrytëzuar asnjëherë dhe rezultojnë të regjistruara në emër të bashkëshortit të ndjerë B.T (babai i subjektit)¹⁰⁰.

28.4 Pasi Komisioni i kërkoi subjektit të deklarojë mbi mënyrën e përfitimit, burimin e krijimit dhe statusin aktual të këtyre pasurive¹⁰¹, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: “...këto toka janë përfituar me ligjin nr. 7501 të vitit 1991. Nuk është bërë çelja e trashëgimisë dhe për këtë shkak është në emër të babait të ndjerë, B.T”¹⁰².

28.5 ASHK Drejtoria Vendore Kukës¹⁰³ ka konfirmuar se: (i) pasuria nr. *** është me emërtimin arë, me sip. 800 m² sipas AMTP-së nr. *** dhe sip. 687 m² sipas LN, e regjistruar në vol. ***, f. ***, z. k. ***, B, në pronësi (familjare) të shtetasit B.H.T, në datën 17.6.2001; (ii) pasuria nr. *** është me emërtimin arë, me sip. 600 m², sipas AMTP-së nr. *** dhe sip. 1437 m² sipas LN, e regjistruar në vol. ***, f. ***, z. k. ***, B, në pronësi (familjare) të shtetasit B.H.T, në datën 17.6.2001.

28.6 Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar mbi këto pasuri rezulton se ato janë përfituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, me AMTP nr. regjistri ***, datë 1.11.1991. Duket se subjekti ka qenë pjesë e familjes bujqësore dhe, si rrjedhojë, për shkak të ligjit ai dispononte/disponon pjesën e tij takuese mbi këto pasuri, pavarësisht nga çelja ose jo e dëshmisë së trashëgimisë ligjore të babait të tij të ndjerë, z. B. T.

28.7 Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pjesën takuese të tij mbi këto pasuri, as në deklaratën fillestare të pasurisë apo në deklaratat periodike vjetore vijuese dhe as në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*.

28.8 Me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegimet/argumentet e tij mbi mosdeklarimin e pjesëve takuese mbi këto pasuri, përkatësisht në deklaratat e interesave privatë/periodikë vjetorë dhe në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*.

28.9 Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti i qëndron shpjegimeve të dhëna më parë, e konkretisht, se këto pasuri tokë arë janë përfituar mbështetur në ligjin nr. 7501 të vitit 1991 dhe se nuk është bërë çelja e trashëgimisë dhe për këtë shkak janë në emër të babait të ndjerë B.T. Në vijim të prapësimeve të tij, subjekti ka sqaruar se pasuria e sipërcituar është regjistruar nga kadastra vetëm në emrin e babait të tij të ndjerë B.T. Kjo ka ndodhur për shkak se babai, në atë kohë, ka qenë kryetar i familjes bujqësore dhe duke qenë i tillë, në regjistrat e kadastrës figuron i regjistruar vetëm ai dhe jo anëtarë të tjerë të familjes, një ndër të cilët ka qenë edhe ai vetë. Ndërkohë, më pas, në vitin 1992, ai është larguar me leje banimi në qytet dhe nuk është marrë më me këtë regjistrim të bërë sa më lart. Në përfundim të prapësimeve të tij lidhur me këtë çështje, subjekti parashtron se në vitin 1993 ka ndërruar jetë babai B.T dhe që nga ajo kohë e në vazhdim nuk janë bërë veprimet ligjore përkatëse për çeljen e trashëgimisë në mënyrë që më pas të paraqitnin të fituar pasurinë trashëgimore që figuronte në emrin e babait në momentet para vdekjes së tij. Për rrjedhojë, edhe kjo pasuri ka vazhduar të figurojë në emër të babait në cilësinë e kryetarit të familjes bujqësore. Në këtë kontekst, subjekti pretendon se nga pikëpamja ligjore nuk mund të deklarojë pasurinë në fjalë në emrin e tij, për sa kohë nuk e kishte fituar pasurinë ligjërisht me anë të çeljes së trashëgimisë.

¹⁰⁰ Në mbështetje të deklarimeve të bëra me dorëzimin e deklaratës *Vetting* – subjekti ka depozituar vërtetimin datë 9.1.2017, lëshuar nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive Kukës (ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së).

¹⁰¹ Pyetja nr. *** e pyetësorit nr. ***.

¹⁰² Në mbështetje të deklarimeve të bëra subjekti ka depozituar shkresën nr. *** prot., datë 10.11.2022, të ASHK-së Drejtoria Vendore.

¹⁰³ Shkresë nr. *** prot., datë 8.11.2022, e ASHK-së Drejtoria Vendore Kukës, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 14.11.2022.

28.10 Në vlerësimin përfundimtar të shpjegimeve të dhëna nga subjekti, Komisioni vlerëson se pavarësisht se pasuritë e sipërcituara janë regjistruar në emër të babait të tij, si kryetar i familjes bujqësore, bazuar në ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e anëtarit të familjes bujqësore, disponon pjesën e tij takuese mbi këtë pasuri (të drejta reale mbi të), e cila është në përpjesëtim të drejtë me numrin e anëtarëve të familjes bujqësore sipas certifikatës familjare datë 1.8.1991. Në këtë kuptim, çelja e dëshmisë do të sillte përfitimin dhe regjistrimin në emrin e subjektit të një pjese shtesë mbi këtë pasuri, në përputhje me pjesën takuese të tij të përcaktuar në çeljen e dëshmisë së trashëgimisë ligjore të babait të ndjerë B.T.

28.11 Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti duhej të kishte treguar kujdes të shtuar në plotësimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, pasi mosdeklarimi i kësaj pasurie apo pjesëve takuese të tij mbi të, e çon atë në kushtet e deklarimit të pasaktë sipas leximit “*a contrario*” të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Gjithsesi, në kushtet kur rezulton se kjo pasuri është deklaruar nga nëna e subjektit në deklaratën e rivlerësimit kalimtar, si dhe për sa kohë provohet se ajo është e fituar me ligj, pra se nuk ka dyshime për krijimin e saj, trupi gjykues konkludon se kjo rrethanë nuk ndikon në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij.

Çështje të tjera

29. Pasuritë arë, truall, ndërtesë dhe karburant, të ndodhura në Kukës dhe të regjistruara në emër të fëmijëve të subjektit si bashkëpronarë, përfituar me trashëgimi

29.1 Nga verifikimi dhe shqyrtimi i informacionit/dokumentacionit të administruar nga regjistri noterial shqiptar, kontratat dhe deklaratat e paraqitura nga noterët publikë, si dhe nga dokumentacioni i paraqitur nga ASHK DV Kukës¹⁰⁴ konstatohet se:

29.1.1 Në momentin e plotësimit të deklaratës për rivlerësimin kalimtar *Vetting*, rezulton se fëmijët e subjektit kanë pasur në pronësi pjesë takuese në disa pasuri të përfituara nga çelja e trashëgimisë në datën 10.6.2008, të gjyshit të tyre, M.M (babai i nënës, i cili ka ndërruar jetë në datën 15.4.2007), duke përfituar nga kjo trashëgimi me zëvendësim të nënës së tyre, të ndjerës F.T (M), e cila kishte ndërruar jetë më herët (më 20.6.2006), konkretisht: (i) pasuria nr. *** e llojit “arë”, me sip. 3,856 m², e ndodhur në Sh, Kukës, në pronësi të shtetasit G. M 85,72%, ndërsa shtetasit E, E dhe B T nga 4,76% secili; (ii) pasuria nr. *** e llojit “arë”, me sip. 13,674 m², e ndodhur në Sh, Kukës, në pronësi të shtetasit G. M 85,72%, ndërsa shtetasit E, E dhe B T nga 4,76% secili; (iii) pasuria nr. *** e llojit “arë”, me sip. 4,406 m², e ndodhur në Sh, Kukës, në pronësi të shtetasit G.M 85,72%, ndërsa shtetasit E, E dhe B T nga 4,76% secili; (iv) pasuria nr. *** e llojit “arë”, me sip. 3,612.5 m², e ndodhur në Sh, Kukës, në pronësi të shtetasit G. M 85,72%, ndërsa shtetasit E, E dhe B. T nga 4,76% secili; dhe (v) pasuria nr. *** (***) e llojit “truall”, me sip. 1,322.5 m² dhe karburant me sipërfaqe ndërtimore 220 m², e ndodhur në Sh, Kukës, në pronësi të shtetasit G. M 83.33%, ndërsa shtetasit E, E dhe B.T nga 5,56% secili.

29.2 Komisioni vendosi të ndalej në mënyrën e përfitimit të pjesëve takuese të pasurisë nr. ***, si më lart në mënyrë kronologjike:

- Në datën 2.5.2003, KRRT-ja Qarku Kukës, me vendimin nr. ***, ndër të tjera, ka vendosur miratimin e projektit të zbatimit të studimit urbanistik pjesor dhe të kondicioneve urbanistike të sheshit të ndërtimit me sip. 4,935 m², fshati M, Komuna Sh dhe ka lëshuar leje ndërtimi për objektin karburant “****”, të ndodhur në fshatin M, Komuna Sh, me subjekt ndërtues shoqëria “****” mbi tokën, e cila ishte në pronësi të shtetasit M.M.

- Në datën 12.5.2003, KRRT Qarku Kukës, me vendimet nr. 1 dhe nr. 2, ka vendosur të miratojë kondicionet urbanistike dhe t’i japë z. M.M sheshin e ndërtimit me sip. 1,322.5 m², me destinacion objekti karburant “****”, fshati M, Komuna Sh, si dhe të miratojë lejen e ndërtimit

¹⁰⁴ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 8.8.2022, e ASHK DV Kukës, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.8.2022.

z. M.M (vjehtëri i subjektit) për objektin karburant “****”, fshati M, Komuna Sh. Objekti financohet nga investitori privat M. M.

- Në datën 28.7.2003, Ministria e Mjedisit ka lëshuar lejen mjedisore për subjektin “****” sh.p.k., me administrator M. M, për aktivitetin “pikë karburanti, servis, bar - restorant”. Sipërfaqe e përgjithshme 4,935 m², kapaciteti 90,000 litra.

- Në datën 30.9.2003, Drejtoria e Urbanistikës Qarku Kukës ka lëshuar lejen e shfrytëzimit për objektin “pikë shitje karburanti” me investitor M. M, ku përcaktohet se vlera e investuar nga fillimi i ndërtimit deri në dorëzimin e punimeve ka qenë 3,091,285 lekë.

- Në datën 14.10.2003, ZVRPP-ja Kukës ka regjistruar pasurinë e llojit “truall” me sip. 1,322.5 m² dhe karburant një kat me sipërfaqe ndërtimore 220 m² në pronësi të shtetasit M.A.M.

- Në datën 10.6.2008, pasi shtetasi M.M kishte ndërruar jetë më 15.4.2007, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, me kërkesë të djalit të tij G. M, ka vendosur të lëshojë dëshminë e trashëgimisë së tij duke përcaktuar trashëgimtarët e radhës së parë bashkëshorten dhe fëmijët e tij me nga 1/7 pjesë takuese, si dhe me zëvendësim hyjnë në trashëgimi fëmijët e dy prej vajzave të tij, të cilat kishin ndërruar jetë më herët më 24.1.1988 (4 fëmijë) dhe më 20.6.2006 F.T (M), 3 fëmijët e këtyre të fundit trashëgojnë në pjesë të barabarta të tre së bashku 1/7 pjesë të trashëgimlënësit M.A.M.

- Në datën 3.7.2008, të gjithë trashëgimtarët e tjerë (përveç fëmijëve të subjektit) kanë hequr dorë nga trashëgimia ligjore, duke ia lënë pjesën e tyre takuese vetëm shtetasit G.M.

- Në datën 16.10.2008, pasuria me nr. ***, z. k. ***, me sip. 1,322.5 m² truall, karburant një kat me sipërfaqe ndërtimore 220 m², është regjistruar në emër të shtetasit G.M (kunati i subjektit) 83,33 % dhe shtetasve E, E dhe B. T (fëmijët e subjektit) me nga 5,56 % pjesë takuese secili.

- Në datën 20.11.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka lëshuar autorizimin nr. 10059, për tjetërsimin e pasurisë së fëmijëve të mitur në favor të subjektit të rivlerësimit Naim Tota.

- Në datën 19.12.2017, shtetasit E dhe B.T kanë lëshuar një prokurë¹⁰⁵ të përgjithshme, në të cilën i japin të drejta të plota shtetasit G.M për të disponuar për të gjitha pasuritë e tyre të paluajtshme.

- Në datën 27.12.2017 shtetasi E.T ka lëshuar në SHBA një prokurë¹⁰⁶ të përgjithshme, në të cilën i jep të drejta të plota shtetasit G.M për të disponuar për të gjitha pasuritë e tij të paluajtshme.

- Në datën 4.12.2018 shtetasit E, E dhe B. T, të përfaqësuar nga shtetasi G.M, kanë nënshkruar deklaratën nr. *** rep., nr. *** kol., me objekt “heqje dorë pa kundërshtpërblim/falas nga bashkëpronësia mbi pasurinë e paluajtshme” (e cila nuk duket të jetë depozituar pranë ASHK-së Kukës e, konkretisht, për pasuritë nr. ***, z. k. ***, me sip. 1,322.5 m² truall, karburant një kat me sipërfaqe ndërtimore 220 m², si dhe 3 nga 4 pasuritë e tjera në të cilat kishin pjesë takuese në listën me 5 prona të cituara në fillim të këtij seksioni, e konkretisht e llojit “arë”: me nr. *** (pasuria nr. ***), me sip. 13,674 m²; nr. *** (pjesë e pasurisë nr. ***), me sip. 2,916 m²; nr. *** (pjesë e pasurisë nr. ***), me sip. 3,158.5 m², të gjitha këto pasuri i kalojnë bashkëpronarit tjetër të tyre, G. M, në masën 100%.

29.3 Pasuria me nr. ***, e llojit “arë” me sip. 3,856 m², vijon të jetë në pronësi të përbashkët të shtetasve G. M 85,72%, E.T 4,76%, E.T 4,76% dhe B. T 4,76%.

¹⁰⁵ Prokurë e përgjithshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.12.2017, redaktuar nga noteri publik, znj. E.T.

¹⁰⁶ Prokurë e përgjithshme datë 27.12.2017, redaktuar nga noteri publik C.A, me vulë apostile datë 12.1.2018, vërtetim përkthimi nga gjuha angleze në gjuhën shqipe me nr. *** rep., datë 19.1.2018.

29.4 Komisioni konstaton se këto pasuri, si dhe ndryshimet e bëra mbi to, nuk janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe/apo personat e lidhur në deklaratat e interesave privatë/periodikë vjetorë dhe as në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*.

29.5 I pyetur nga Komisioni lidhur me këto pasuri, faktin e mosdeklarimit të tyre, si dhe mbi investimet e mundshme të kryera mbi to, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nga ana e fëmijëve të tij është hequr dorë nga pasuria që kanë pasur në bashkëpronësi me dajën e tyre, G. M.

29.6 Në mbështetje të deklarimeve të tij, subjekti ka depozituar: (i) vendimin e gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. *** akti, nr. vendimi ***, datë 20.11.2008 (evidentuar si më sipër nga Komisioni); si edhe (ii) deklaratën noteriale të datës 28.3.2009.

29.7 Në referim të deklaratës noteriale¹⁰⁷ datë 28.3.2009, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e bashkëshortit të shtetasës së ndjerë F.T (M) dhe njëkohësisht si babai i 3 fëmijëve të mitur E, E dhe B.T (të cilët janë trashëgimtarë me zëvendësim) ka deklaruar, ndër të tjera, se si përfaqësues i fëmijëve të tij, heqin dorë nga pasuria tokë bujqësore e fituar në bazë të ligjit nr. ***, datë 19.7.1991, nga F.T, si pjesëtare e familjes në datën 1.8.1991, dhe gjithashtu heqjen dorë nga të gjitha pasuritë e fituara dhe ato që do të përfitohen nga ky ligj duke ia lënë në pronësi pjesën e tyre takuese vëllait të bashkëshortes së tij, z. G.M (daja i fëmijëve të tij).

29.8 Nisur nga kjo deklaratë, subjekti pretendon se ka qenë detyrim i dajës së fëmijëve të bënte veprimet përkatëse për këto pasuri në regjistrat e hipotekës, konkretisht të heqjes dorë nga fëmijët e tij mbi këto pasuri.

29.9 Në lidhje me pasuritë, të cilat figurojnë ende në bashkëpronësi të fëmijëve të tij, subjekti pretendon se ato janë deklaruar prej tyre në ILDKPKI, si persona të lidhur, të cilët mbartin detyrimin për deklarim. Por, nga verifikimi i deklaratave të interesave privatë/periodikë vjetorë të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, si dhe i deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, nuk rezulton që prej personave të lidhur, fëmijëve të subjektit, të jetë deklaruar bashkëpronësia mbi këto pasuri, si pasuri veçmas të disponuar prej tyre.

29.10 Për sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, duke i kërkuar të japë shpjegimet/argumentet mbi mosdeklarimin prej tij dhe/apo personave të lidhur të pjesëve takuese mbi këto pasuri dhe ndryshimet e bëra ndër vite në to, përkatësisht, në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë dhe në atë *Vetting*.

29.11 Nëpërmjet prapësimeve të depozituara, subjekti i ka qëndruar deklarimeve të dhëna më parë gjatë hetimit administrativ, duke sqaruar edhe një herë se nga ana e fëmijëve të tij është hequr dorë nga pasuria që kanë pasur në bashkëpronësi me dajën e tyre G.M. Për këtë është paraqitur vendimi nr. ***, datë 20.11.2008, i gjykatës dhe deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.3.2009. Pra, sipas subjektit, referuar dokumentacionit të sipërcituar, rezulton qartë që ligjërisht është hequr dorë për të gjitha pasuritë që fëmijët e tij kanë pasur në bashkëpronësi, duke përfshirë edhe pasurinë në pikën e fundit të trajtuar nga Komisioni¹⁰⁸. Në këtë aspekt, subjekti parashtron se nga pikëpamja ligjore ka qenë detyrim i dajës së tyre G.M që të bënte veprimet përkatëse për pasqyrimin në regjistrat e hipotekës të heqjes dorë të fëmijëve të tij nga bashkëpronësia.

29.12 Në vlerësimin përfundimtar të shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti, Komisioni vëren se bazuar në autorizimin e marrë nga gjykata, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e kujdestarit ligjor konform nenit 343 e vijues të Kodit Civil dhe konform neneve 231 - 234 të Kodit të Familjes të kohës, ka hequr dorë nga këto pasuri që në vitin 2009. Kështu, trupi gjykues arrin në përfundimin se ka qenë detyrim i dajës së fëmijëve paraqitja e deklaratës

¹⁰⁷ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.3.2009, redaktuar nga noteri publik, znj. M.Ll.

¹⁰⁸ I referohet materialit “Rezultatet e hetimit administrativ”.

noteriale të bërë prej tij në datën 28.3.2009, për heqjen dorë nga këto pasuri dhe regjistrimin e tyre vetëm në emrin e tij.

29.13 Në vlerësim të këtyre rrethanave, Komisioni gjen bindëse shpjegimet e dhëna nga subjekti mbi mosdeklarimin e këtyre pasurive në vite, të përfituara me trashëgim prej fëmijëve të tij nga nëna e tyre e ndjerë¹⁰⁹, kjo pasi duket se në momentin që ka marrë dijeni, në kushtet kur edhe fëmijët kanë qenë të mitur, ai ka hequr dorë prej tyre.

29.14 Në këtë këndvështrim, në momentin e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, duket se disa pasuri figuronin në emër të fëmijëve të subjektit, pikërisht për shkak të moskryerjes së procedurave përkatëse nga daja e tyre e, konkretisht, mosdepozitimit prej tij në zyrën e regjistrimit të pasurive të deklaratës noteriale të bërë nga kujdestari i tyre për heqjen dorë nga këto pasuri. Në arritjen e këtij përfundimi të çojnë edhe dokumentet noteriale të nënshkruara në vijim prej tyre¹¹⁰ (fëmijëve të subjektit) gjatë viteve 2017 - 2018, tashmë në cilësinë e personave madhorë, nëpërmjet të cilave i japin të drejta të plota dajës së tyre, G.M, për ndarjen e këtyre pasurive, kanë hequr dorë prej tyre apo e kanë autorizuar për shitje, duke referuar se nuk pretendojnë asnjë vlerë nga shitja e tyre, pra duke pranuar *de facto* heqjen dorë nga këto pasuri dhe fryte të mundshme nga zhvillimi apo shitja e tyre.

29.15 Për sa më sipër, në vlerësimin tërësor të rrethanave lidhur me mënyrën e përfitimit të këtyre pasurive nga fëmijët e subjektit, faktit se ata kanë qenë të mitur në momentin e përfitimit, si dhe për sa kohë në cilësinë e kujdestarit të tyre ligjor ai ka deklaruar heqjen dorë prej këtyre pasurive që në vitin 2009, duket se subjekti i rivlerësimit ka qenë në padijeni të faktit se në momentin e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, fëmijët e tij kanë pasur të regjistruar pasuri në bashkëpronësi me dajën e tyre, G.M dhe si rrjedhim, mosdeklarimi i pjesëve të tyre takuese vlerësohet se nuk mund të sjellë pasoja në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij.

30. Analiza financiare për vitet 2002 – 2016

30.1 Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI, si dhe në përgjigje të pyetësorëve të dërguar gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën paraprake të treguesve financiarë lidhur me pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit për çdo vit, për periudhën 2002 – 2016, nga ku duket se vitet 2004, 2005, 2006, 2007, 2009 dhe 2011 paraqiten me balancë negative të fondeve, me një balancë totale negative në shumën prej rreth 4,000,000 lekësh.

30.2 Pas kalimit të barrës së provës mbi rezultatet e analizës financiare, krahas shpjegimeve dhe provave të depozituara në lidhje me burimet e të ardhurave të personave të tjerë të lidhur, për dhënien e shumave hua në favor të bashkëshortes së subjektit, të ndjerës F.T, në vitin 2005, të cilat janë analizuar në trajtimin e bërë mbi mundësinë e kryerjes së investimit në shoqërinë “****” sh.a., dega Kosovë, si më sipër në këtë vendim, Komisioni verifikoi dhe analizoi pretendimet e tjera të ngritura nga subjekti i rivlerësimit me dërgimin e prapësimeve dhe provueshmërinë e tyre, për sa vijon:

i. Për vitin 2004, i cili sipas analizës financiare paraprake rezulton me balancë negative fondesh -376,269 lekë, subjekti parashton se duhet të reflektohen si të ardhura shtesë të ardhurat e tij nga paga për një periudhë 5-mujore, përkatësisht për muajt gusht - dhjetor 2004, të cilat i janë konfirmuar rishtazi pas interesimit të bërë prej tij. Në mbështetje të pretendimit të

¹⁰⁹ Rezulton se edhe shtetasja F.T i ka përfituar këto pasuri me trashëgim nga babai i saj i ndjerë.

¹¹⁰ (i) Prokurë e përgjithshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.12.2017, redaktuar nga noteri publik, znj. E.T; (ii) deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.1.2018, nëpërmjet së cilës kanë dhënë të drejta për ndarjen e pasurisë, redaktuar nga noteri publik, z. A.E; (iii) deklaratë noteriale për heqje dorë pa kundërshtim/falaz nga bashkëpronësia mbi pasurinë me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.12.2018.

bërë, subjekti ka depozituar si provë vërtetimin¹¹¹ e lëshuar nga DRSSH-ja Kukës, datë 6.2.2023.

Bazuar në të dhënat e referuara në dokumentin e sipërcituar, Komisioni vendosi të shtojë në analizën financiare përfundimtare të ardhurat e subjektit për vitin 2004, në shumën 306,550 lekë dhe, si rrjedhojë, rezultati i balancës negative për këtë vit shkon -70,719 lekë.

ii. Siç u evidentua edhe më sipër, për vitin 2005 janë reflektuar ndryshime në analizën financiare, bazuar në përfundimin e arritur se personat e tjerë të lidhur kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht shumat e dhëna hua në favor të bashkëshortes së ndjerë F.T. Si rrjedhim, balanca negative e fondeve për këtë vit shkon në vlerën -527,339 lekë.

Sillet në vëmendje këtu se sa i përket këtij viti, subjekti pretendon se në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë të depozituar në ILDKPKI, ka deklaruar gjendje likuiditetesh *cash* dhe jo shtesë të tyre. Në këtë këndvështrim, nëse do të merrej për bazë edhe ky pretendim, balanca negative e fondeve për këtë vit do të shkonte në -27,339 lekë.

iii. Për vitin 2006, subjekti ka pretenduar se ka përfutur të ardhura në formë shpërblimi për humbjen e jetës së bashkëshortes F.T, në dukje në total në shumën 780,000 lekë. Në mbështetje të deklarimeve të tij, subjekti ka depozituar dokumentet: (a) vërtetim nr. *** prot., datë 1.2.2023, i shoqërisë “****” sh.a.; dhe (b) deklaratë noteriale¹¹² datë 2.2.2023, e shtetasit B.Sh, identifikuar si punonjës me rol drejtues i shoqërisë “****” sh.a.

Me anë të vërtetimit të lëshuar nga shoqëria “****” sh.a., konfirmohet se në mbështetje të regjistrit të shpenzimeve për vitin 2006 rezulton se kjo shoqëri ka kryer pagesa në favor të shtetasit Naim Tota, në datën 11.10.2006, vlerën prej 180,000 lekësh, nëpërmjet çekut bankar pranë “Credins Bank”, si dhe në datën 27.6.2006, vlerën prej 100,000 lekësh, nëpërmjet arkës së shoqërisë.

Bazuar në të dhënat e referuara në dokumentin e sipërcituar, Komisioni vendosi të reflektojë në analizën financiare përfundimtare të ardhura shtesë për vitin 2006, në shumën 280,000 lekë.

Ndërsa, referuar deklarimeve të bëra nga shtetasi B.Sh, me anë të dokumentit noterial të datës 2.2.2023, pretendohet se në vitin 2006 shoqëria “****” sh.a. i ka akorduar shtetasit Naim Tota shumën prej rreth 500,000 lekësh apo 5,000 euro, për shkak të ndërrimit të jetës së bashkëshortes së tij, të ndjerës F.T, e cila ishte punonjëse e shoqërisë, pasi, sipas deklaruesit, shoqëria e ka pasur dhe vazhdon ta ketë të zakonshme një praktikë të tillë, aq më tepër për rastin në fjalë për shkak të moshës së re të të ndjerës dhe rrethanave të tjera familjare u pa e arsyeshme dhënia e një vlere të tillë. Lidhur me këtë pretendim, Komisioni vlerëson se mbetet i karakterit deklarativ dhe, si i tillë, nuk mund të merret në konsideratë për efekt të analizës financiare.

Pas shqyrtimit të pretendimeve të bëra nga subjekti, lidhur me rezultatin e analizës financiare për vitin 2006, balanca negative e fondeve për këtë vit shkon në vlerën -534,540 lekë.

Sillet në vëmendje këtu se edhe sa i përket këtij viti, subjekti pretendon se në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë të depozituar në ILDKPKI ka deklaruar gjendjen e likuiditeteve *cash* dhe jo shtesë të tyre. Në këtë këndvështrim, nëse do të merrej për bazë edhe ky pretendim, balanca negative e fondeve për këtë vit do të shkonte në -34,540 lekë.

iv. Për vitin 2007, i cili sipas analizës financiare paraprake rezulton me balancë negative fondesh -250,951 lekë, subjekti ka kërkuar që të reflektohet gjendja *cash* e llogaritur prej tij, në dukje në vijim të raporteve të tij mbi pasaktësitë e pranuar në deklarin e likuiditeteve

¹¹¹ Vërtetim mbi bazën e vlerësueshme nr. *** prot., datë 6.2.2023, lëshuar nga DRSSH-ja Kukës.

¹¹² Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.2.2023, redaktuar nga noteri publik, znj. I.Sh.

cash ndër vite, duke pretenduar se kjo rrethanë e rivlerësuar do të bënte që balanca e fondeve për këtë vit të rezultonte pozitive.

Komisioni vlerësoi se ky pretendim mbetet i karakterit deklarativ dhe, si i tillë, nuk mund të ndikojë në rezultatin e analizës financiare që i përket vitit 2007.

v. Për rezultatin financiar që i përket vitit 2009, i cili paraqitet me balancë negative fondesh në shumën -194,275, subjekti ka pretenduar që të reflektohen të ardhurat e deklaruara prej tij si të përfituara nga interesat e huas, të dhëna në favor të shtetasit T.H.

Edhe ky pretendim nuk u mor në konsideratë nga Komisioni, pavarësisht se këto të ardhura janë deklaruar në deklaratën e interesave privatë periodikë/vjetorë të vitit 2009. Por, për sa kohë nuk provohet pagesa e detyrimit tatimor lidhur me to, pra nuk provohet ligjshmëria e këtyre të ardhurave në përmbushje të standardit kushtetues, sipas nenit D/3 të Aneksit të Kushtetutës, ato nuk mund të përfshihen në analizën financiare të këtij viti. Si rrjedhim, rezultati i vitit 2009 mbetet i pandryshuar.

vi. Sa i përket balancës negative të konstatuar për vitin 2011, subjekti ka pretenduar se pagesa ndaj universitetit privat ***, për kryerjen e studimeve të doktoraturës, në total në shumën 5,000 euro, është kryer e shpërndarë në vite, me këste gjatë viteve 2011 – 2015 dhe jo e gjitha në vitin 2011, siç është reflektuar në analizën financiare paraprake të kryer nga Komisioni. Në mbështetje të deklarimeve të tij, subjekti ka depozituar si provë të re vërtetimin nr. *** prot., datë 8.2.2023, të ***, nëpërmjet të cilit konfirmohet se shtetasi Naim Tota ka qenë i regjistruar në programin e doktoraturës në *** dhe ka kryer pagesën në vlerën 5,000 euro, me këste, për periudhën 2011 – 2015. Gjithashtu, bashkëlidhur këtij vërtetimi evidentohet një mandatpagesë, në referim të së cilës duket se në vitin 2011 shtetasi Naim Tota ka kryer në favor të ***-së pagesën prej 1,000 euro.

Bazuar në vërtetimin e ***, Komisioni vendosi të pranojë pretendimin e subjektit, duke shpërndarë pagesën për studimet e doktoraturës, si të kryer me këste gjatë viteve 2011 – 2015. Si rrjedhim, rezultati financiar i vitit 2011, nga balancë negative në shumën -407,211 lekë, shkon me balancë pozitive. Gjithashtu, Komisioni vëren se kjo shpërndarje e pagesës për studimet e doktoraturës nuk afekton rezultatin financiar për vitet 2012 – 2015.

30.3 Për sa më sipër, pas reflektimit të ndryshimeve të cilat gjenin mbështetje në dokumentacionin justifikues ligjor, referuar rezultatit përfundimtar të analizës financiare¹¹³ – Komisioni konstaton se vitet 2004, 2005, 2006, 2007 dhe 2009 paraqiten me balancë negative fondesh, për një total të akumuluar prej -1,577,274 lekësh, nga ku evidentohet se me balancë negative të konsiderueshme paraqiten vitet 2005, 2006 dhe 2007, vite për të cilat subjekti pretendon se ka pasur pasaktësi në deklarimin e likuiditeteve *cash*, si dhe viti 2009, për të cilin subjekti pretendon të reflektohen të ardhurat e deklaruara nga interesat e huas.

30.4 Komisioni vëren se sa i përket deklarimit të likuiditeteve gjendje *cash*, me dërgimin e prapësimeve shtesë pas rezultateve të hetimit, subjekti ka parashtruar se ka pasur pasaktësi në deklarimin e tyre, kjo për shkak të orientimit të gabuar nga vetë inspektorët e ILDKPKI-së në fillimet e dorëzimit të deklaratave, si dhe moskuptimit të drejtë të deklarimeve të bëra për gjendjen e likuiditeteve *cash*. Në këtë kontekst kërkon të merret për bazë analiza e bërë nga ekspertja J.M.¹¹⁴, bazuar në logjikën e tij të deklarimit, kjo sipas tij edhe në përputhje me disa qëndrime të mbajtura nga Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit mbi logjikën e deklarimit të gjendjes *cash*, për shkak se ai nuk është pyetur më parë mbi këto deklarime, si dhe

¹¹³ Referohuni tabelës përmbledhëse të analizës financiare, aneks nr. 1, pjesë e këtij vendimi.

¹¹⁴ Me dërgimin e prapësimeve pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimi ka depozituar si provë aktekspertimin kontabël datë 17.2.2023, i kryer nga audituesja ligjore J.M, pajisur me nr. licence ***, në të cilin reflektohen ndryshimet në analizë financiare sipas pretendimeve të ngritura nga subjekti, si dhe në mbështetje të provave shtesë të administruara prej tij.

për faktin që ai nuk i ka pretenduar dhe nuk i pretendon ato shtesa dhe as ka deklaruar likuiditet gjendje *cash* në deklaratën *Vetting*.

30.5 Nisur nga pretendimet e ngritura nga subjekti lidhur me deklaratimet e bëra mbi likuiditetet *cash*, të cilat kryesisht ndikojnë në rezultatin financiar të viteve 2005, 2006 dhe 2007, Komisioni analizoi kuadrin ligjor lidhur me detyrimin e deklaratimit të kësaj pasurie.

30.6 Kështu, referuar nenit 4, germa “d” e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, “Për deklaratimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, subjektet detyrohen të deklarojnë vlerën e likuiditeteve, gjendjen *cash* jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj, si dhe burimin e krijimit të tyre.

30.7 Ndërsa në nenin 21 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, përcaktohet se: “*Deklarimi i pasurive, i burimeve të tyre, i detyrimeve financiare bëhet sipas kërkesave të përcaktuara në këtë ligj dhe në formën e përcaktuar nga Inspektori i Përgjithshëm*”.

30.8 Kështu, rezulton se në formularët e deklaratimit të pasurisë, në seksionin “deklarimi i interesave privatë – pasuritë e luajtshme/pasuritë e paluajtshme”, që i përket deklaratës së interesave privatë të viteve 2005 dhe 2006 dhe në seksionin “ndryshimet e interesave privatë – pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, që i përket deklaratës së interesave private të vitit 2007, kërkohet nga deklaruesit që të pasqyrojnë ndryshimet (shtesa dhe pakësime) e ndodhura në interesat pasurorë privatë të deklaruar më parë, për çdo lloj pasurie, të luajtshme dhe të paluajtshme, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklaratimit.

30.9 Si rrjedhim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklaronte ndryshimet, shtesat apo pakësimet e ndodhura të pasurisë së llojit likuiditet gjendje *cash*, në formularët e deklaratimit të pasurive të depozituara në ILDKPKI dhe mbi këtë përfundim është kryer edhe analiza financiare përfundimtare.

30.10 Por, nga ana tjetër, Komisioni vëren se vetëm me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 85/2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, ‘Për deklaratimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve vendorë dhe të disa nëpunësve publikë’”, të ndryshuar, e konkretisht në nenin 5 të tij, me anë të të cilit është ndryshuar neni 7 i ligjit nr. 9049/2003, ndër të tjera, përcaktohet se: “*Në deklaratimin periodik vjetor jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat privatë, të deklaruar më parë...*”.

30.11 Në këtë kontekst, nuk mund të përjashtohet mundësia që subjekti i rivlerësimit të ketë pasur logjikë të gabuar në deklaratimin e likuiditeteve *cash* ndër vite, në kundërshtim me kërkesat e formularit të deklaratimit të pasurive. Kjo rrethanë sigurisht vlerësohet në raport me faktin se rezulton e vërtetë se subjekti nuk është pyetur më parë për deklaratimet e likuiditeteve *cash*. Pra, nëse Komisioni do të merrte në konsideratë këtë pretendim duket se do të reduktohej ndjeshëm balanca negative e fondeve në analizën financiare e, më konkretisht, për vitet 2005, 2006 dhe 2007, nga totali i balancës negative prej -1,312,830 lekësh, në totalin e balancës negative prej rreth -62,000 lekësh.

30.12 Gjithsesi, Komisioni i qëndron rezultatit financiar të referuar si më sipër, pra se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të evidentuara për vitet 2004, 2005, 2006, 2007 dhe 2009, për një total balance negative në shumën -1,577,274 lekë.

30.13 Por, duke risjellë në vëmendje se vetë natyra e analizës financiare është e përafërt dhe jo absolute, e cila mund të paraqesë një shkallë të caktuar pasaktësie në elementet që vlerëson, kjo edhe për shkak të rrethanave të relatuara më sipër, si dhe në konsideratë të faktit nga ku rezulton

se kjo balancë negative është e shpërndarë në vite dhe duket se nuk ka ndikim thelbësor në krijimin e pasurive të materializuara dhe të deklaruara si gjendje në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, trupi gjykues arrin në përfundimin se ajo nuk është e tillë për t'u konsideruar si deklarim i pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

Konkluzion i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

31. Nga hetimi administrativ i kryer dhe shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, rezulton se subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

31.1 Subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë, në përputhje me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Ai ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit Naim Tota nuk vërtetohen shkaqe që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

31.2 Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se pasaktësitë e konstatuara dhe balancat negative të fondeve të rezultuara për disa vite nuk janë të mjaftueshme që të sjellin aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për më tepër, Komisioni, gjatë hetimit administrativ, konstatoi se pasaktësitë e konstatuara dhe balancat negative të fondeve për disa vite të caktuara nuk kanë ndikuar në mënyrë thelbësore në cenimin e burimit të krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit.

31.3 Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklarimet e pasakta të konstatuara si më sipër dhe problematikat e evidentuara në analizën financiare, nuk çmohen të mjaftueshme për cenimin e kriterit të pasurisë apo të vlerësohen si të tilla që të ndikojnë në vlerësimin tërësor në procesin e rivlerësimit të kryer për këtë subjekt. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe mungesës së pasojave, pasaktësitë e konstatuara nuk cenojnë figurën e prokurorit dhe as besimin e publikut te drejtësia, pasi vlerësimi duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit.

31.4 Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Naim Tota ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës "a" të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

32. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Naim Tota, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse ai ka pasur/ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

33. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës¹¹⁵ së subjektit të rivlerësimit Naim Tota, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej tij në deklaratën për kontrollin e figurës; dhe (iii) për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

¹¹⁵ Raporti nr. *** prot., datë 2.11.2017.

34. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Naim Tota.

35. Komisioni ka kërkuar nga DSIK-ja¹¹⁶ përditësimin e raportit mbi kontrollin e figurës me informacione reja të mundshme të përcjella rishtazi nga organet e verifikimit, për subjektin e rivlerësimit Naim Tota. DSIK-ja ka dërguar në Komision shkresat e administruara nga institucionet e verifikimit – pas përpilimit të raportit mbi kontrollin e figurës për këtë subjekt. Nga verifikimi i tyre nuk rezultoi të jenë përcjellë informacione apo sinjalizime mbi kontakte të papërshtatshme dhe/apo përfshirjen e subjektit të rivlerësimit Naim Tota në veprimtari të kundërligjshme.

36. Në këtë kontekst, DSIK-ja nuk ka përpiluar një raport të ri për subjektin e rivlerësimit Naim Tota, por se me vendimin nr. ***, datë 17.6.2022, të KDZH-së, ka deklasifikuar plotësisht raportin mbi kontrollin e figurës të dërguar më parë në Komision, me konstatimin për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

37. Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetin e subjektit të rivlerësimit Naim Tota, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese. Nga hetimi administrativ i kryer nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzion i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

38. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Naim Tota ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

39. Objekti i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i veprimtarisë etike dhe profesionale i subjekteve të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve¹¹⁷.

40. Raporti i mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale në Këshillin e Lartë të Prokurorisë

40.1 Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin e aftësive profesionale të prokurorëve, ka përpiluar dhe miratuar raportin për vlerësimin e aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit Naim Tota, i cili është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave dhe dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, me short; si dhe (iii) të dhënave nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve gjyqësore.

40.2 Referuar raportit, subjekti i rivlerësimit Naim Tota identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në vijim konstatohet se prokurori Naim Tota ka shfaqur aftësi në interpretimin e ligjit, analizën e jurisprudencës dhe arsyetimin ligjor e logjik, duke marrë vendime dhe përpiluar akte të qarta e të plota. Ka rezultuar se ai është eficient dhe i aftë për të përballuar ngarkesën në punë dhe në kryerjen e veprimtarisë hetimore dhe gjyqësore, ku përfshihet edhe kontrolli i hetimeve të

¹¹⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 13.5.2022, e Komisionit.

¹¹⁷ Referuar nenit 40 të ligjit nr. 84/2016.

kryera nga policia gjyqësore për të mbështetur akuzën në çështjet me të pandehur të dërguar për gjykim. Gjithashtu rezultoi se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm, si dhe nuk janë konstatuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit.

Rivlerësimi i aftësive profesionale i kryer nga Komisioni

41. Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në verifikimin dhe analizimin e: (i) raportit për analizimin e aftësisë profesionale të kryer nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe dokumentacionit bashkëlidhur tij; (ii) denoncimeve të depozituara nga publiku dhe shqyrtimit të dokumentacionit të administruar në këtë kuadër; si dhe (iii) kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

42. Komisioni, me qëllim të vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet e përzgjedhura me short, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorëve të rretheve gjyqësore. Pas verifikimit të raportit për analizën e aftësive profesionale të kryer Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë si organi ndihmës për vlerësimin profesional, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënave nga burimet arkivore mbi të cilën është hartuar ky raport, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me vlerësimin profesional.

43. Në vlerësimin e prokurorit Naim Tota, u mbajtën në vëmendje dhe u analizuan edhe 14 denoncime të depozituara nga publiku. Pas verifikimit dhe analizimit të tyre, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime dhe të provojë me dokumentacion justifikues ligjor mbi veprimet e kryera prej tij në hetimin dhe/apo shqyrtimin e çështjeve që lidhen me 9 denoncime të depozituara nga publiku, përkatësisht denoncimet/ankesat e bëra nga shtetasit F. H¹¹⁸, Q.D¹¹⁹, J. H¹²⁰, I.T¹²¹, F. Y¹²², A. M¹²³, M. Z¹²⁴, A. C¹²⁵ dhe E. D¹²⁶. Më konkretisht, pas shqyrtimit të tyre dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni konstatoi se: (i) evidentohen raste të prishjes së vendimeve të mosfillimit dhe/apo pushimit të procedimit penal nga gjykata, duke u konstatuar prej saj mungesa e kryerjes së veprimeve hetimore dhe/apo duke u orientuar kryerja e veprimeve hetimore konkrete; (ii) evidentohen çështje në të cilat prokurori Naim Tota nuk ka zbatuar detyrat e lëna nga gjykata në hetimin e tyre, arsye për të cilën, pas kërkesës së bërë prej tij për pushimin e çështjes, gjykata ka vendosur kthimin e akteve dhe vazhdimin e hetimeve; (iii) evidentohet një rast në të cilin prokurori Tota ka vendosur regjistrimin e një procedimi penal për një vepër tjetër, ndryshe nga sa kishte urdhëruar gjykata; (iv) evidentohet material kallëzues i trajtuar nga prokurori Tota, për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal përtej afatit të përcaktuar në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale.

¹¹⁸ Ankesë nr. *** prot., datë 23.1.2018.

¹¹⁹ Ankesë nr. *** prot., datë 7.5.2018; ankesë nr. *** prot., datë 23.2.2021; ankesë nr. *** prot., datë 22.2.2021; ankesë nr. *** prot., datë 31.1.2019; ankesë nr. *** prot., datë 10.6.2019.

¹²⁰ Ankesë nr. *** prot., datë 7.10.2019; ankesë nr. *** prot., datë 22.6.2018/9; ankesë nr. *** prot., datë 8.6.2018.

¹²¹ Ankesë nr. *** prot., datë 26.7.2018.

¹²² Ankesë nr. *** prot., datë 14.6.2019; ankesë nr. *** prot., datë 27.6.2019.

¹²³ Ankesë nr. *** prot., datë 19.9.2018; ankesë nr. *** prot., datë 18.6.2020; ankesë nr. *** prot., datë 13.7.2021; ankesë nr. *** prot., datë 12.9.2018.

¹²⁴ Ankesë nr. *** prot., datë 10.6.2019.

¹²⁵ Ankesë nr. *** prot., datë 13.9.2021.

¹²⁶ Ankesë nr. *** prot., datë 24.5.2021.

44. Me anë të prapësimeve të depozituara, si dhe gjatë seancave dëgjimore, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet/argumentet e tij, si dhe ka depozituar dokumentacion provues në mbështetje të tyre për kërkesat e bëra dhe problematikat e ngritura nga Komisioni në trajtimin e denoncimeve të depozituara nga publiku.

45. Komisioni, pasi i vlerësoi me objektivitet, çmon se subjekti ka argumentuar dhe arsyetuar në mënyrë bindëse dhe në nivel ligjor mbi kërkesat dhe/apo gjetjet e evidentuara në trajtimin e denoncimeve të depozituara nga publiku, ku nga vlerësimi tërësor i tyre nuk vërehen rrethana që mund të përbëjnë shkelje procedurale, të tilla që mund të çojnë në konkluzione negative lidhur me kriterin e rivlerësimit të aftësive profesionale.

46. Për më tepër, Komisioni vëren se ankesat e kryera ndaj prokurorit Tota, në pjesën më të madhe të tyre janë për çështje të hetuara prej tij pas fillimit të procesit të rivlerësimit kalimtar dhe kryesisht për çështje të cilat kanë qenë në hetim në momentin e depozitimit të denoncimit, nga ku duket se në disa raste mbi materialin e referuar nga policia gjyqësore ky prokuror ka vendosur mosfillimin e procedimit dhe, më pas, bazuar në vendimet e gjykatave për regjistrimin e procedimeve dhe pas kryerjes së veprimeve hetimore shtesë – nisur nga provat dhe rrethanat e reja që kanë dalë rishtazi gjatë hetimit, ka vendosur dërgimin e çështjes në gjyq, duke treguar se vendimet e tij nuk kanë qenë të ndikuara nga faktorë të jashtëm, por se kanë qenë kryesisht të bazuara në vlerësimin e materialit kallëzues dhe provave të administruara, në përputhje me bindjen e tij të brendshme.

47. Në këtë kontekst, në kushtet kur për disa nga çështjet e trajtuara – bazuar në denoncimet e depozituara nga publiku – qëndrimi fillestar i subjektit nuk përputhet me qëndrimin e mbajtur nga gjykata, kjo në fazën e hetimeve paraprake, duket sikur prej tij nuk është vlerësuar drejt materiali kallëzues në momentin e parë të marrjes për trajtim. Por, nga ana tjetër, evidentohet se pikërisht për këto çështje, për të cilat fillimisht është vendosur mosfillimi dhe më pas regjistrimi i procedimit, e në vijim pas kryerjes së veprimeve hetimore është dërguar çështja për gjykim, gjykata ka vendosur pushimin e tyre (vendime për të cilat subjekti ka kryer edhe ankime). Në trajtimin e çështjeve të denoncuar, situata të ngjashme vërehen edhe në rastet e regjistrimit të procedimeve nga ana e subjektit dhe pas kryerjes së disa veprimeve hetimore – depozitimit prej tij të kërkesave për pushimin e çështjes – për të cilat gjykata ka konstatuar mungesën e kryerjes së veprimeve hetimore apo ka orientuar kryerjen e veprimeve hetimore konkrete dhe në vijim rezulton se pas kryerjes së këtyre veprimeve hetimore shtesë është konfirmuar vendimi i pushimit apo se vetë prokurori Tota, bazuar në provat dhe rrethanat e reja që kanë dalë rishtazi gjatë hetimit, ka vendosur dërgimin e çështjes për gjykim.

48. Për sa u arsyetua më sipër, pas trajtimit të rasteve për të cilat prokurori Naim Tota fillimisht ka vendosur mosfillim procedimi, por edhe në vlerësim të rasteve të tjera në të cilat rezulton se ka vendosur pushimin e çështjes, por gjykata ka urdhëruar kryerjen e veprimeve të tjera hetimore, vërehet se pretendimet e ngritura në denoncimet e depozituara nga publiku lidhen kryesisht me themelin e çështjes, pra se ato janë të tilla që kanë të bëjnë me vlerësimin e provave dhe të ligjit të zbatueshëm nga ana e prokurorit Tota dhe, në këtë kuptim, çmohet se përbëjnë objekt shqyrtimi gjyqësor nga gjykatat.

Konkluzion për kriterin e vlerësimit profesional

49. Në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, denoncimeve të depozituara nga publiku dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje procedurale, gabime thelbësore dhe serioze apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara prej subjektit të rivlerësimit, gjë që mund të çonte në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale.

50. Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe në rekomandimet e relatores së çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se subjekti i rivlerësimit:

- a. arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. arrin nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

Për këto arsye,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Naim Tota, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më 10.3.2023

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda BEKTESHI
Kryesuese

Pamela QIRKO
Relatore

Roland ILIA
(Anëtar në pakicë/kundër)

Sekretare gjyqësore
Amela Idrizi

ANEKS NR. 1

TABELA PËRMBLEDHËSE E ANALIZËS FINANCIARE PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT NAIM TOTA

	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
A) Pasuri	1,900,992	350,000	150,000	2,103,286	744,978	384,612	205,807	703,259	50,832	-62,435	37,811	4,315,762	180,469	61,803	-1,173,250
Apartament në Kukës	1,900,992														
Apartament në Tiranë, blerë në vitin 2016															6,226,000
Aksionet në shoqërinë "****" Sh.a., investuar në vitin 2005				1,546,288											
Automjetet I markës **** blerë në vitin 2014.													280,220		
Ndryshim likuiditeti	0	350,000	150,000	556,998	744,978	384,612	205,807	703,259	50,832	-62,435	37,811	4,315,762	-99,751	61,803	-7,399,250
B) Detyrime	1,799,444	0	0	1,400,000	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Detyrime ndaj EKB Kukës	1,799,444														
Detyrime ndaj M. D				1,000,000											
Detyrime ndaj R. S				400,000											
C) Pasuri neto	101,548	350,000	150,000	703,286	744,978	384,612	205,807	703,259	50,832	-62,435	37,811	4,315,762	180,469	61,803	-1,173,250
D) Të ardhura	904,229	1,299,709	745,831	889,090	1,468,803	924,553	5,927,982	1,247,435	1,354,829	1,491,801	1,451,000	7,014,558	1,862,056	2,158,664	1,875,443
Të ardhura, shpërblime për fatkeqësinë					280,000										
Të ardhura nga paga subjekti i rivlerësimit	748,880	1,122,490	717,271	711,250	1,032,471	790,765	863,300	1,098,179	1,121,994	1,042,580	1,047,623	1,119,464	1,293,093	1,331,159	1,364,365
Të ardhura nga paga bashkëshortja F.T	130,683	151,365		146,520	73,718										
Të ardhura nga paga bashkëshortja E.T									81,019	291,745	243,081	422,939	404,353	411,936	391,789
Të ardhura nga pensioni familjar për fëmijët					47,568	95,136	95,136	95,136	95,136	95,136	95,136	95,136	95,136	95,136	47,568
Të ardhura nga pensioni i nënës së subjektit	24,666	25,854	28,560	31,320	35,046	38,652	42,246	54,120	56,680	62,340	65,160	67,519	69,474	70,433	71,721
Të ardhura nga shitja e aksioneve të "****" sh.a							4,927,300								
Të ardhura nga shitja e automjetit të markës ****, viti 2015														250,000	
Të ardhura nga shitja e apartamentit në Kukës, viti 2013												5,309,500			
E) Shpenzime	563,184	618,985	665,550	713,143	1,258,365	790,892	5,666,201	738,901	1,145,842	1,393,060	971,153	1,862,365	1,460,098	1,483,306	1,494,290
Shpenzime minimale jetese	563,184	563,184	563,184	657,342	602,564	683,100	683,100	683,100	683,100	683,100	775,632	846,144	1,319,988	1,345,656	1,410,552
Shpenzime për shlyerjen e huasë ndaj R. S (R. M)					400,000										
Shpenzime për shlyerjen e huasë ndaj M. D					200,000				400,000						
Shpenzime për shlyerjen e kredisë ndaj EKB Kukës		55,801	55,801	55,801	55,801	55,801	55,801	55,801	55,801	55,801	55,801	869,000			
Shpenzime për dhënie hua ndaj shtetasit T. H							4,927,300								
Shpenzime për arsye shëndetësore										414,900					
Shpenzime udhëtimi jashtë vendit			46,565			51,991			6,941	100,959		7,011			83,738
Shpenzime për studimet pas universitare										138,300	139,720	140,210	140,110	137,650	
Balanca e Fondeve (D-C-E)	239,497	330,724	-69,719	-527,339	-534,540	-250,951	55,974	-194,725	158,155	161,176	442,036	836,432	221,489	613,555	1,554,403